60 61 62 63 64 65 66 67 68 69 70 71 72 73 74 75 76 77 78 79 80 81 82 83 84 85 86 87 88 89 90 91 92 93 94 95 96 97 98 99 100 101 102 103 104 105 106 107 108 109 110 111 112 113 114 115 116 117 118 119 120 121 122 123 124 125 126 127 128 129 130 131 132 133 134 135 136 137 138 139 140 141 142 143 144 145 146 147 148 149 150 151 152 153 154 155 156 157 158 159 160 161 162 163 164 165 166 167 168 169 170 171 172 173 174 175 176 177 178 179 180 181 182 183 184 185 186 187 188 189 190 191 192 193 194 195 196 197 198 199 200 201 202 203 204 205 206 207 208 209 210 211 212 213 214 215 216 217 218 219 220 221 222 223 224 225 226 227 228 229 230 231 232 233 234 235 236 237 238 239 240 241 242 243 244 245 246 247 248 249 250 251 252 253 254 255 256 257 258 259 259 260 261 262 263 264 265 266 267 268 269 270 271 272 273 274 275 276 277 278 279 279 280 281 282 283 284 285 286 287 288 289 289 290 291 292 293 294 295 296 297 298 299 299 300 301 302 303 304 305 306 307 308 309 309 310 311 312 313 314 315 316 317 318 319 319 320 321 322 323 324 325 326 327 328 329 329 330 331 332 333 334 335 336 337 338 339 339 340 341 342 343 344 345 346 347 348 349 349 350 351 352 353 354 355 356 357 358 359 359 360 361 362 363 364 365 366 367 368 369 369 370 371 372 373 374 375 376 377 378 379 379 380 381 382 383 384 385 386 387 388 389 389 390 391 392 393 394 395 396 397 397 398 399 399 400 401 402 403 404 405 406 407 408 409 409 410 411 412 413 414 415 416 417 417 418 419 419 420 421 422 423 424 425 426 427 427 428 429 429 430 431 432 433 434 435 436 437 437 438 439 439 440 441 442 443 444 445 445 446 447 447 448 449 449 450 451 452 453 454 455 455 456 457 457 458 459 459 460 461 462 463 464 465 465 466 467 467 468 469 469 470 471 472 473 474 475 475 476 477 477 478 479 479 480 481 482 483 484 485 485 486 487 487 488 489 489 490 491 492 493 494 494 495 496 496 497 498 498 499 499 500 501 502 503 503 504 505 505 506 507 507 508 509 509 510 511 511 512 513 513 514 515 515 516 517 517 518 519 519 520 521 521 522 523 523 524 525 525 526 527 527 528 529 529 530 531 531 532 533 533 534 535 535 536 537 537 538 539 539 540 541 541 542 543 543 544 545 545 546 547 547 548 549 549 550 551 551 552 553 553 554 555 555 556 557 557 558 559 559 560 561 561 562 563 563 564 565 565 566 567 567 568 569 569 570 571 571 572 573 573 574 575 575 576 577 577 578 579 579 580 581 581 582 583 583 584 585 585 586 587 587 588 589 589 590 591 591 592 593 593 594 595 595 596 597 597 598 599 599 600 601 601 602 603 603 604 605 605 606 607 607 608 609 609 610 611 611 612 613 613 614 615 615 616 617 617 618 619 619 620 621 621 622 623 623 624 625 625 626 627 627 628 629 629 630 631 631 632 633 633 634 635 635 636 637 637 638 639 639 640 641 641 642 643 643 644 645 645 646 647 647 648 649 649 650 651 651 652 653 653 654 655 655 656 657 657 658 659 659 660 661 661 662 663 663 664 665 665 666 667 667 668 669 669 670 671 671 672 673 673 674 675 675 676 677 677 678 679 679 680 681 681 682 683 683 684 685 685 686 687 687 688 689 689 690 691 691 692 693 693 694 695 695 696 697 697 698 699 699 700 701 701 702 703 703 704 705 705 706 707 707 708 709 709 710 711 711 712 713 713 714 715 715 716 717 717 718 719 719 720 721 721 722 723 723 724 725 725 726 727 727 728 729 729 730 731 731 732 733 733 734 735 735 736 737 737 738 739 739 740 741 741 742 743 743 744 745 745 746 747 747 748 749 749 750 751 751 752 753 753 754 755 755 756 757 757 758 759 759 760 761 761 762 763 763 764 765 765 766 767 767 768 769 769 770 771 771 772 773 773 774 775 775 776 777 777 778 779 779 780 781 781 782 783 783 784 785 785 786 787 787 788 789 789 790 791 791 792 793 793 794 795 795 796 797 797 798 799 799 800 801 801 802 803 803 804 805 805 806 807 807 808 809 809 810 811 811 812 813 813 814 815 815 816 817 817 818 819 819 820 821 821 822 823 823 824 825 825 826 827 827 828 829 829 830 831 831 832 833 833 834 835 835 836 837 837 838 839 839 840 841 841 842 843 843 844 845 845 846 847 847 848 849 849 850 851 851 852 853 853 854 855 855 856 857 857 858 859 859 860 861 861 862 863 863 864 865 865 866 867 867 868 869 869 870 871 871 872 873 873 874 875 875 876 877 877 878 879 879 880 881 881 882 883 883 884 885 885 886 887 887 888 889 889 890 891 891 892 893 893 894 895 895 896 897 897 898 899 899 900 901 901 902 903 903 904 905 905 906 907 907 908 909 909 910 911 911 912 913 913 914 915 915 916 917 917 918 919 919 920 921 921 922 923 923 924 925 925 926 927 927 928 929 929 930 931 931 932 933 933 934 935 935 936 937 937 938 939 939 940 941 941 942 943 943 944 945 945 946 947 947 948 949 949 950 951 951 952 953 953 954 955 955 956 957 957 958 959 959 960 961 961 962 963 963 964 965 965 966 967 967 968 969 969 970 971 971 972 973 973 974 975 975 976 977 977 978 979 979 980 981 981 982 983 983 984 985 985 986 987 987 988 989 989 990 991 991 992 993 993 994 995 995 996 997 997 998 999 999 1000 1000 1001 1001 1002 1002 1003 1003 1004 1004 1005 1005 1006 1006 1007 1007 1008 1008 1009 1009 1010 1010 1011 1011 1012 1012 1013 1013 1014 1014 1015 1015 1016 1016 1017 1017 1018 1018 1019 1019 1020 1020 1021 1021 1022 1022 1023 1023 1024 1024 1025 1025 1026 1026 1027 1027 1028 1028 1029 1029 1030 1030 1031 1031 1032 1032 1033 1033 1034 1034 1035 1035 1036 1036 1037 1037 1038 1038 1039 1039 1040 1040 1041 1041 1042 1042 1043 1043 1044 1044 1045 1045 1046 1046 1047 1047 1048 1048 1049 1049 1050 1050 1051 1051 1052 1052 1053 1053 1054 1054 1055 1055 1056 1056 1057 1057 1058 1058 1059 1059 1060 1060 1061 1061 1062 1062 1063 1063 1064 1064 1065 1065 1066 1066 1067 1067 1068 1068 1069 1069 1070 1070 1071 1071 1072 1072 1073 1073 1074 1074 1075 1075 1076 1076 1077 1077 1078 1078 1079 1079 1080 1080 1081 1081 1082 1082 1083 1083 1084 1084 1085 1085 1086 1086 1087 1087 1088 1088 1089 1089 1090 1090 1091 1091 1092 1092 1093 1093 1094 1094 1095 1095 1096 1096 1097 1097 1098 1098 1099 1099 1100 1100 1101 1101 1102 1102 1103 1103 1104 1104 1105 1105 1106 1106 1107 1107 1108 1108 1109 1109 1110 1110 1111 1111 1112 1112 1113 1113 1114 1114 1115 1115 1116 1116 1117 1117 1118 1118 1119 1119 1120 1120 1121 1121 1122 1122 1123 1123 1124 1124 1125 1125 1126 1126 1127 1127 1128 1128 1129 1129 1130 1130 1131 1131 1132 1132 1133 1133 1134 1134 1135 1135 1136 1136 1137 1137 1138 1138 1139 1139 1140 1140 1141 1141 1142 1142 1143 1143 1144 1144 1145 1145 1146 1146 1147 1147 1148 1148 1149 1149 1150 1150 1151 1151 1152 1152 1153 1153 1154 1154 1155 1155 1156 1156 1157 1157 1158 1158 1159 1159 1160 1160 1161 1161 1162 1162 1163 1163 1164 1164 1165 1165 1166 1166 1167 1167 1168 1168 1169 1169 1170 1170 1171 1171 1172 1172 1173 1173 1174 1174 1175 1175 1176 1176 1177 1177 1178 1178 1179 1179 1180 1180 1181 1181 1182 1182 1183 1183 1184 1184 1185 1185 1186 1186 1187 1187 1188 1188 1189 1189 1190 1190 1191 1191 1192 1192 1193 1193 1194 1194 1195 1195 1196 1196 1197 1197 1198 1198 1199 1199 1200 1200 1201 1201 1202 1202 1203 1203 1204 1204 1205 1205 1206 1206 1207 1207 1208 1208 1209 1209 1210 1210 1211 1211 1212 1212 1213 1213 1214 1214 1215 1215 1216 1216 1217 1217 1218 1218 1219 1219 1220 1220 1221 1221 1222 1222 1223 1223 1224 1224 1225 1225 1226 1226 1227 1227 1228 1228 1229 1229 1230 1230 1231 1231 1232 1232 1233 1233 1234 1234 1235 1235 1236 1236 1237 1237 1238 1238 1239 1239 1240 1240 1241 1241 1242 1242 1243 1243 1244 1244 1245 1245 1246 1246 1247 1247 1248 1248 1249 1249 1250 1250 1251 1251 1252 1252 1253 1253 1254 1254 1255 1255 1256 1256 1257 1257 1258 1258 1259 1259 1260 1260 1261 1261 1262 1262 1263 1263 1264 1264 1265 1265 1266 1266 1267 1267 1268 1268 1269 1269 1270 1270 1271 1271 1272 1272 1273 1273 1274 1274 1275 1275 1276 1276 1277 1277 1278 1278 1279 1279 1280 1280 1281 1281 1282 1282 1283 1283 1284 1284 1285 1285 1286 1286 1287 1287 1288 1288 1289 1289 1290 1290 1291 1291 1292 1292 1293 1293 1294 1294 1295 1295 1296 1296 1297 1297 1298 1298 1299 1299 1300 1300 1301 1301 1302 1302 1303 1303 1304 1304 1305 1305 1306 1306 1307 1307 1308 1308 1309 1309 1310 1310 1311 1311 1312 1312 1313 1313 1314 1314 1315 1315 1316 1316 1317 1317 1318 1318 1319 1319 1320 1320 1321 1321 1322 1322 1323 1323 1324 1324 1325 1325 1326 1326 1327 1327 1328 1328 1329 1329 1330 1330 1331 1331 1332 1332 1333 1333 1334 1334 1335 1335 1336 1336 1337 1337 1338 1338 1339 1339 1340 1340 1341 1341 1342 1342 1343 1343 1344 1344 1345 1345 1346 1346 1347 1347 1348 1348 1349 1349 1350 1350 1351 1351 1352 1352 1353 1353 1354 1354 1355 1355 1356 1356 1357 1357 1358 1358 1359 1359 1360 1360 1361 1361 1362 1362 1363 1363 1364 1364 1365 1365 1366 1366 1367 1367 1368 1368 1369 1369 1370 1370 1371 1371 1372 1372 1373 1373 1374 1374 1375 1375 1376 1376 1377 1377 1378 1378 1379 1379 1380 1380 1381 1381 1382 1382 1383 1383 1384 1384 1385 1385 1386 1386 1387 1387 1388 1388 1389 1389 1390 1390 1391 1391 1392 1392 1393 1393 1394 1394 1395 1395 1396 1396 1397 1397 1398 1398 1399 1399 1400 1400 1401 1401 1402 1402 1403 1403 1404 1404 1405 1405 1406 1406 1407 1407 1408 1408 1409 1409 1410 1410 1411 1411 1412 1412 1413 1413 1414 1414 1415 1415 1416 1416 1417 1417 1418 1418 1419 1419 1420 1420 1421 1421 1422 1422 1423 1423 1424 1424 1425 1425 1426 1426 1427 1427 1428 1428 1429 1429 1430 1430 1431 1431



## HYRJE

Kryqi i Kuq në shërbim të njeriut, mbështetje për njerëzit që janë gjetur në një situatë të pa-lakmueshme. Kryqi i Kuq me më të vegjlit, me të moshuarit, me institucionet, me shërbimet për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vazhdojmë të punojmë me përkushtim mbi parimet dhe idealet e themeluesit tonë Anri Dynan i cili ka pasur aq porosi dhe ide humane sa që edhe pas një shekulli e gjysmë të ekzistimit të Lëvizjes sonë të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, akoma janë udhëzues për të ecur rrugës së njëjtë, i cili ngjall buzëqeshje dhe shpresë të singertë për njerëzit që presin për t'ua zgjatur dorën kur e kanë më vështirë.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut me kallimin e viteve u rit në një organizatë që është ndihmëtar i respektuar i institucioneve të shtetit në përbushjen e detyrave të ndryshme me interes për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kultivojmë vullnetarizmin dhe kemi mbështetjen e qytetarëve në komunitetet lokale për të qenë gjithmonë aty ku është e nevojshme.

Dr. Sait Saiti

Sekretar i Përgjithshëm

Vazhdojmë të sigurojmë shërbime që janë në përputhje me misionin dhe mandatin tonë. Këtë vit shënojmë gjithashtu 75-vjetorin e ekzistimit të Organizatës sonë, krenarë për arritjet tona, të gatshëm për t'u përballur me të gjitha sfidat e reja.

Jemi të gatshëm të mësojmë nga e kaluara, të jemi të gatshëm për të ardhmen, të jemi më të mirë dhe më të suksesshëm, gjithmonë në shërbim të përfituesve të shërbimeve tona.

Në këtë rrugë, ecim së bashku me partnerët dhe vullnetarët tanë. Falenderim për të gjithë ata që vazhdojnë të na mbështesin dhe të na njohin si faktor që mund t'u përgjigjet sfidave të ndryshme në interes të kategorive të ndryshme të përdoruesve të cilëve ua ofrojmë shërbimet tona. Programi i Punës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 le të jetë një motiv më shumë për të gjithë ne që të jemi më përgjegjës, për të dhënë më të mirën nga vetja, në realizimin e qëllimeve tona të përcaktuara, për të ndihmuar njerëzit dhe për të dhënë kontributin në zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe më humane.

Prof.Dr. Romel Velev

Krytar



## LËVIZJA NDËRKOMBËTARE E KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

Kryqi i Kuq është lindur më 24 qershori të vitit 1859 në zemrën e biznesmenit zviceran, Anri Dynan (1828 – 1910), pas një prej betejave më të përgjakshme të shkullit, Beteja e Solferinos. Ai është themeluesi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në vitin 1863 që më vonë rezultoi me krijimin e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në vitin 1919 dhe Shoqatave Nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe si lëvizje globale e cila sot ka 100 milionë vullnetarë dhe anëtarë në të gjithë botën dhe përfshin aktivitetet e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe Shoqatave Nacionale, siç është gjithashtu Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### KOMITETI NDËRKOMBËTAR I KRYQIT TË KUQ

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) është një organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, misioni humanitar i të cilit është të mbrojë jetën dhe dinjitetin e viktimateve të luftës dhe dhunës së brendshme, si dhe të sigurojë ndihmë.

Menaxhon dhe koordinon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës humanitare të Lëvizjes në situata konflikti. Themeluar në vitin 1863, KNKK ka një mandat të besuar nga Shtetet, i bazuar në Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtese. Gjatë konflikteve të armatosura kujdeset për: të plagosurit, luftëtarët e sëmurë, si dhe luftëtarët që kanë pësuar anijethyerje; personat e privuar nga liria (robër lufte, civilë të paraburgosur), njerëz të detyruar të transferohen në pjesë të tjera të vendit (persona të zhvendosur) ose në një vend tjetër (refugjatë) dhe ndihmon civilët. KNKK këshillon shtetet për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe përdor Mesazhet e Kryqit të Kuq për të rivendosur dhe mirëmbajtur lidhjet familjare duke shkëmbyer lajme midis anëtarëve të familjes. KNKK gjithashtu regjistron të burgosurit e luftës, ndërmerr hapa për të siguruar që ata të mos zhduken, punon për të parandaluar torturimin dhe keqraitimini e të burgosurve dhe për të përmirësuar kushtet e burgut. KNKK gjithashtu në zona të luftës siguron trajtimin mjekësor (ndihmën e parë, evakuimin e të plagosurve, kirurgjinë ushtarake, rehabilitimin fizik), mjekësinë parandaluese (vaksinimin, ushqimin, edukimin shëndetësor, sigurimin e ujit dhe ushqimit, veshmbathjen, strehimin për civilët në zonat e prekura nga lufta).



## FEDERATA NDËRKOMBËTARE E KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe është themeluar në vitin 1919 nga disa Shoqata Nacionale dhe ka këto detyra themelore: ofrimin e ndihmës për viktimat e katastrofës, sigurimin e kujdesit për refugjatët në vendet e tjera, ofrimin e ndihmës për shoqatat nacionale në kryerjen e aktiviteteve programore në rast katastrofash; koordinon aktivitetet midis shoqatave nacionale. Për më tepër, Federata Ndërkombëtare, përmes delegacioneve të saj rajonale në të gjithë botën, siguron mbështetje për shoqatat nacionale në përmirësimin e aftësive të tyre njerëzore dhe materiale, në mënyrë që të jenë më të përgatitura për të kryer aktivitetet e tyre programore dhe për të siguruar një përgjigje të përshtatshme përsituata të ndryshme krize.

## SHOQATAT NACIONALE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

Sot, ka 190 Shoqata Nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe të njoitura Ndërkombëtarisht në të gjithë botën, anëtare të Federatës Ndërkombëtare

të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Shoqatat Nacionale janë njësítë themelore të Lëvizjes dhe kryejnë aktivitetet e tyre humanitare në përputhje me statutin e tyre dhe legjislacionin nacional. Shoqatat nacionale ndihmojnë autoritetet shtetërore në detyrat e tyre humanitare, sipas nevojave të popullsisë në vendet e tyre. Shoqatat nacionale bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore për parandalimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe zbutjen e vuajtjeve njerëzore përmes programeve të tyre në fushën e arsimit, kujdesit shëndetësor dhe social për të mirën e komunitetit. Organizojnë operacione urgjente për të siguruar ndihmë humanitare, dhe ofrojnë edhe shërbime të tjera për të ndihmuar viktimat e konflikteve të armatosura në përputhje me Konventat e Gjenevës, dhe sigurojnë ndihmë për viktimat e katastrofave natyrore dhe situatave të tjera të jashtëzakonshme. Ato punojnë për diseminimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare, përhapjen e parimeve dhe idealeve të Lëvizjes dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e emblemave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ndërkombëtarisht, shoqatat nacionale, secila brenda mundësive të tyre, ofrojnë ndihmë për viktimat e konflikteve të armatosura, katastrofave natyrore dhe situatave të tjera të jashtëzakonshme nëpër botë.



## LETËNJOFTIMI KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Humanizmi dhe aktivitetet humanitare janë të njoitura dhe ekzistojnë në këto hapësira për më shumë se njëqind vjet. Me kalimin e viteve Kryqi i Kuq ka siguruar mbështetje gjatë Luftërave Ballkanike dhe dy Luftërave Botërore. Qytetarët e Maqedonisë në mënyrë vetëmohuese kanë siguruar mbështetje humanitare gjatë këtyre luftërave përmes Organizatës së Kryqit të Kuq.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë u krijua zyrtarisht më 17 mars të vitit 1945, pas mbajtjes së Mbledhjes së Dytë të ASNOM-it kur u mor vendimi për krijimin e një organizate në Maqedoninë Demokratike brenda Jugosllavisë Federative Demokratike.

Organizata është veçanërisht aktive në rimëkëmbjen e vendit pas luftës dhe në zbatimin e programeve parandaluese shëndetësore dhe sociale për grupe të ndryshme të synuara. Nga viti 1946 deri më 1948, Kryqi i Kuq u përfshi aktivisht në ofrimin e përkrahjes dhe kujdesit përfshirë refugjatë nga Maqedonia e Egjeut. Në vitet në vijim, organizohen aksione të grumbullimit të ndihmës, organizohen dhurime vullnetare të gjakut, kryhen veprimitari shëndetësore dhe veprimitari të tjera humanitare, kryhen aktivitete edukative të popullsisë. Kryqi i Kuq jep një kontribut të veçantë me punën e tij në përblytjet që prekin Maqedoninë në vitin 1962, dhe kryesisht pas tërmetit katastro-

fik të vitit 1963, kur Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë përfaqëson një urë solidariteti midis botës dhe popullsisë së vuajtur të Maqedonisë dhe me këtë rast me vullnetarët dhe punonjësit e tij koordinon dhe shpërndan ndihmën ndërkombëtare për popullsinë e prekur dhe mbështet funksionimin e spitaleve në terren ku janë të pranishëm përfaqësues të Kryqit të Kuq nga shumë vende.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë në vitin 1992, Organizata vepron si një Shoqatë e pavarur Nacionale. Puna e Shoqatës Nacionale rregullohet me një Ligj të veçantë për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë. Organizata përbëhet nga 33 organizata komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, 10.500 anëtarë dhe 7.500 vullnetarë aktivë. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë është njohur si Shoqatë Nacionale e Kryqit të Kuq nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq më 01.11.1995, ndërsa më 27 nëntor të vitit 1995 u bë anëtar i plotë i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Në vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar ne kemi qenë dëshmitarë të një katastrofe të madhe humanitare si rezultat i luftës në ish-Jugosllavi. Në bashkëpunim me partnerët e Lëvizjes u ofrua ndihmë në reduktimin e vuajtjeve të mijëra refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga ish-republikat jugosllave që kërkuan strehim në vendin tonë. Ngjarja kryesore e

operacioneve humanitare të asaj periudhe ishte ofrimi i mbështetjes për rreth 400.000 refugjatë kosovarë në vitin 1999. Kryqi i Kuq ishte aktiv edhe gjatë konfliktit të brendshëm në vend në vitin 2001, kur iu dha mbështetje personave të zhvendosur brenda vendit dhe përmes veprimit të saj Organizata promovon tolerancën dhe bashkëjetesën në Republikën e Maqedonisë.

Në dekadën e kaluar, Organizata ka dhënë një kontribut të veçantë në ofrimin e mbështetjes humanitare për popullsinë e prekura në shumë vende të botës. Ekipet e Kryqit të Kuq të Maqedonisë morën pjesë në operacionet e shpëtimit për popullsinë e prekur pas tërmetit të vitit 1999 në Turqi. Disa ekipe të ujت dhe mjete financiare janë siguruar për të mbështetur popullsinë e goditur nga cunami në Indonezi, Malajzi dhe Sri Lankë në vitin 2005. Në të njëjtin vit u dha mbështetje me ekipe vlerësimi për popullsinë e prekur nga përbrytjet në Rumania dhe Bullgari. Shoqata Nacionale nisi gjithashtu një fushatë të madhe për të mbështetur popullsinë e prekur nga tërmeti i vitit 2011 në Japoni. Në vitin 2014, Kryqi i Kuq i Maqedonisë gjithashtu koordinoi fushatën humanitare për të ndihmuar popullsitë e prekura nga përbrytjet në Serbia, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Me 24 korrik të vitit 2015, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, i ndau Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë Mirënjojen "Karta e Republikës

së Maqedonisë", me rastin e 70-vjetorit të themelimit, si një organizatë që përmes zbatimit të aktivitetave të shumta humanitare në sfera të ndryshme të veprimit, ka dhënë kontribut të veçantë në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për popullsinë e prekshme në vend dhe më gjerë, dhe kështu edhe në afirmimin dhe promovimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe vlerave humane.

Në periudhën e viteve 2015-2016, Kryqi i Kuq ka punuar për të kapërcyer pasojat e përbrytjeve të mëdha që kanë prekur vendin dy herë në Tetovë dhe Shkup, si dhe në Maqedoninë qendrore. Në bashkëpunim me agjencitë dhe institucionet shtetërore përgjegjëse, Shoqata Nacionale ka qenë një lider në përpjekjet humanitare për të bashkërenduar mbështetjen e përgjithshme për të ofruar ndihmë ndërkombëtare dhe lokale për popullsinë e prekur. Në periudhën e viteve 2014-2019, Shoqata Nacionale në bashkëpunim me palët e interesuara vendase në vend dhe organizatat ndërkombëtare partnere ka ofruar mbështetje humanitare për migruesit që kalojnë transit ose qëndrojnë në vend. Mbi 1.000.000 migrues kanë kaluar nëpër vendin tonë, dhe gati 50% e këtyj grupi të synuar janë mbështetur nga Kryqi i Kuq duke ofruar ndihmën e parë, transportin në spital, ushqimin, veshmbathjen dhe produktet e higjienës dhe bashkimin e familjeve të ndara.



Në vitet e kaluara, Shoqata Nacionale ka mësuar, është përmirësuar dhe përsosur vazhdimesht, gjë që ka rezultuar me mirënjojen më të lartë të Federatës Ndërkombe të në vitin 2015, e cila i dha Kryqit të Kuq të Maqedonisë Certifikatën e parë si Shoqatë e fortë Nacionale e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për përbushjen e standardeve dhe cilësinë e punës. Kryqi i Kuq përfaqëson një burim krenarie nationale në të gjitha komunititetet lokale në vend dhe Organizata kultivon vlerat dhe parimet themelore evropiane dhe botërore të humanizmit, tolerancës, bashkëjetesës, paanshmërisës.

Me ndryshimet kushtetuese dhe ndryshimin e emrit të shtetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata Nacionale në vitin 2019 ndryshoi emrin në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këtë vit Kryqi i Kuq i RMV-së shënon 75 vjet të ekzistencës së tij. 75 vjet së bashku me qytetarët tanë. Rruga e gjatë e zhvillimit të Organizatës përshkohet me arritje të mëdha dhe veprimtari të suksesshme humanitare që janë treguar në kartën e identitetit (letërnjoftimin) të Organizatës. Zhvillimi i suksesshëm historik i Shoqatës Nacionale

ka kontribuar në përfshirjen e madhe të vullnetarëve në Kryqin e Kuq dhe mbështetjen e vazdueshme të partnerëve të huaj dhe vendas. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet bashkëpunimit të suksesshëm me institucionet shtetërore dhe vendin dhe rolin e Kryqit të Kuq në përballimin e situatave të ndryshme të krizave në vend dhe rajon. Për t'u përmendur është bashkëpunimi gjithnjë e më i suksesshëm me sektorin e korporatave dhe organizatat ndërkombe që e njohin Kryqin e Kuq si një partner të denjë për implemtimin e aktiviteteve të ndryshme për të përbushur nevojat me prioritet të grupeve të ndryshme të synuara.

Jubileu 75-vjeçar do të shënohet me aktivitete të përshtatshme të Organizatës në nivel nacional dhe lokal. Jemi krenarë për jubileun dhe arritjet tona dhe jemi vazhdimesht të gatshëm për një përparim pozitiv dhe nisma, veprimtari dhe shërbime të reja sipas së cilave jemi të njojur me dekada, por edhe prezentimin e shërbimit të ri në përputhje me tendencat moderne në shoqëri.

Gëzuar jubileun. Bëhuni pjesë e Kryqit të Kuq për shumë vite të tjera.





## ROLI NDIHMËS DHE MANDATI I KRYQIT TË KUQ NË VEND

Funksionimi i Kryqit të Kuq në vend bazohet në Ligjin e Kryqit të Kuq dhe Statutin e Organizatës dhe Dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe luan një rol ndihmës për autoritetet gjatë kohës së luftës dhe në kohë paqe, në mënyrë që të vendosen parakushtet e nevojshme të funksionimit në raste urgjente. Pas Luftës së Dytë Botërore, paqja afatgjatë mbizotëroi në pjesën më të madhe të botës, duke lejuar shoqatat nacionale të përqendrohen në aktivitete të tjera të dedikuara për të përmirësuar jetën e popullsisë lokale, si dhurimi i gjakut, ndihma e parë dhe më shumë aktivitete parandaluese-shëndetësore, aktivitete humanitare sociale për kategori të ndryshme të përfituesve, gatishmëri dhe reagim ndaj fatkeqësive, etj., në varësi të interesit të Shoqatës Nacionale ose ndonjë organizate të caktuar komunale. Këto aktivitete janë të natyrës sociale, të dedikuara për mirëqenien e komunitetit dhe kërkojnë bashkëpunim partneritetesh për të përbushur nevojat me prioritet të popullsisë.

Përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë anëtarë të shtabeve kryesore të menaxhimit të krizave në vend (Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Qendra e Menaxhimit të Krizave) përgjegjës për trajimin e situatave të ndryshme të

krizave. Pjesëmarrja në këto shtabe është në dy nivele. Në nivelin nacional dhe në nivelin e organizatave komunale të Kryqit të Kuq, ku përfaqësuesit e OKKK-ve janë anëtarë të shtabeve të njësive rajonale të institucioneve të lartpërmendura. Gjatë situatave të ndryshme të krizave, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut së bashku me institucionet brenda sistemit të menaxhimit të krizave jepin një kontribut të veçantë me burimet materiale dhe njerëzore në tekalimin e pasojave të këtyre situatave të krizës.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në një nivel jashtëzakonisht të lartë dhe reflektohet në aktivitetet për ofrimin e mbështetjes për popullsinë e prekur në kohë krize, si dhe në organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ndryshme të ushtrimeve të dedikuara për të siguruar mbrojtje dhe ndihmë efektive në operacionet humanitare për kapërcimin e pasojave të situatave të krizës. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut siguron trajnime në të drejtën ndërkombëtare humanitare për oficerët e ARM-së dhe merr pjesë me burimet e tij njerëzore dhe teknike në ushtrime të ndryshme të organizuara nga ARM-ja.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme në fushën e shërbimit të kërkimit dhe rivendosjes së lidhjeve familjare, kryerjes së trajnimeve për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm, sigurinë në rrugë dhe promovime të përbashkëta të ndihmës së parë për të mbrojtur sigurinë e qytetarëve, për të ofruar trajnime të ndihmës së parë dhe trajnime të së drejtës ndërkontëtare humanitare për pjesëtarët e MPB-së. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Institutin për Veprimtari Sociale, si dhe institucionet dhe ente sociale në nivelin lokal që ofrojnë përkujdesje dhe sigurojnë mbrojtje sociale për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, përkujdesje për të moshuarit, përkujdesje për jetimët, të pastrehët, fëmijët në rrugë, personat në rrezik social, migruesit, azilkërkuesit, refugjatët etj.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut kryen veprimtari të përbashkëta me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore në vend në nivel nacional dhe lokal. Veçanërisht i suksesshëm është bashkëpunimi në fushën e dhurimit të gjakut i realizuar në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit dhe Fondin

e Sigurimeve Shëndetësore me qëllim të sigurimit të gjakut të sigurt dhe të besueshëm për nevojat e institucioneve shëndetësore në vend. Bashkëpunimi është realizuar edhe në fushën e përparimit të parandalimit shëndetësor dhe promovimit për një shëndet më të mirë të popullsisë me theks në grupet e synuara specifike. Kryqi i Kuq jep një kontribut të veçantë në përmirësimin e ndihmës së parë në vend duke ofruar trajnime për grupe të ndryshme të synuara. Shoqata Nacionale gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Veçanërisht duhet të theksohet bashkëpunimi i njësive të vetëqeverisjes lokale me organizatat komunale të Kryqit të Kuq, të cilat në disa zona lokale financojnë nismat e projektit dhe zbatojnë aktivitete të përbashkëta.

Me iniciativën e Komitetit Ndërkontëtar të Kryqit të Kuq në vitin 2006, u krijua një Komitet Nacional për të Drejtën Ndërkontëtare Humanitare. Selia e Komitetit është në ambientet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Komiteti Nacional përfshin përfaqësues nga të gjitha ministritë që kanë pika kontakti që lidhen me harmonizimin e legjislativit national me të drejtën ndërkontëtare humanitare, implementimin efektiv të DNH-së duke marrë dhe monitoruar masa dhe aktivitete praktike, monitorimin e zhvillimit të DNH-së dhe diseminimin e tij në segmente të ndryshme të jetës shoqërore





## KORNIZA NORMATIVE

Kryqi i Kuq i RMV-së në procesin e ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit, vazhdimisht përmirëson kornizën ligjore duke aplikuar dhe ndjekur azhurnimet në legjislacionin e brendshëm dhe aktet normative të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe përmes implementimit në aktet e tij të brendshme. Vitet e fundit është rritur numri i dokumenteve të miratuar jo vetëm në sasi, por ato kanë luajtur një rol kryesor në standardizimin e çështjeve të caktuara në fushat individuale. E gjithë kjo çon në nevojën për implementimin dhe zbatimin e duhur të rregullimit të brendshëm dhe respektimin e vazdueshëm të tij.

Përmirësimi i kornizës normative kërkon gjithash tu përmirësimin e burimeve njerëzore të Kryqit të Kuq në të gjitha nivelet e strukturimit organizativ, të cilat do të monitorojnë zbatimin e dokumenteve dhe do të propozojnë risi sipas proceseve që ndodhin brenda dhe jashtë vendit të lidhura me misionin dhe vizionin e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë Veriore.

**Qëllimi kryesor:** Krijimi i një procesi të vazdueshëm të përmirësimit dhe implementimit të kornizës së brendshme normative

### Aktivitetet

**Nisma për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve pozitive ligjore.** Kryqi i Kuq do të marrë pjesë aktive në proceset e miratimit të rregulloreve të reja dhe ndryshimit dhe plotësimit të atyre ekzistuese në ato fusha në të cilat vepron dhe funksionon Kryqi i Kuq, përmes propozimeve dhe iniciativave në bashkëpunim me autoritetet shtetërore. Për këtë qëllim, do të ndërmerren aktivitetet e nevojshme përgatitore, do të bëhet hulumtimet e nevojshme, do të rishikohen dokumentet nga shoqatat e tjera nationale përmënyrën e rregullimit të një çështje konkrete përtë bërë analiza krahasuese dhe përgatitjen e zgjidhjes më të mirë si propozim dhe iniciativë. Në rast të pranimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara nga Kryqi i Kuq, do të pasojë përgatitja dhe miratimi i akteve të reja ose modifikimi i akteve të brendshme ekzistuese të Kryqit të Kuq për çështjen përkatëse.

**Rishikimi i akteve ekzistuese dhe miratimi i akteve të reja normative.** Kryqi i Kuq do të vëzhgojë vazhdimisht risitë dhe ndryshimet në legjislacionin nacional në fushat brenda së cilave lëvizin aktivitetet e Kryqit të Kuq dhe do

t'i përfshijë ato në punën e tij, si dhe risitë dhe ndryshimet në Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Përmirësimi i kornizës normative do të bëhet përmes monitorimit, pjesëmarrjes aktive të ekspertëve dhe organeve ndihmëse përmes iniciativave dhe propozimeve, krijimit të grupeve të punës me anëtarë me njohuri dhe përgatitje të përshtatshme për çështjen specifike që i nënshtrohet rregullimit. E gjithë kjo do të kontribuojë në përgatitjen dhe miratimin e akteve të reja të brendshme dhe ndryshimit dhe plotësimit të tyre.

**Implementimi dhe mbështetja në implementimin e akteve normative.** Kryqi i Kuq do t'i kushtohet zbatimit të plotë dhe të vazhdueshëm të të gjitha risive dhe ndryshimeve në rregulloret e brendshme. Trajnine, punëtori dhe konsultime dhe prezantime do të organizohen për të njohur sekretarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në të gjitha nivelet e organizimit me ndryshimet dhe plotësimet në aktet e brendshme. Mbështetje e vazhdueshme do të ofrohet për OKKK-të dhe KKQSH-në, si dhe për punonjësit e Zyrës Qendrore të Kryqit të Kuq të RMV-së për implementimin e duhur të akteve, mbështetje në përgatitjen e akteve, vendimeve, përfundimeve, aktvendimeve, marrëveshjeve, etj., dhe vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbështetjes dhe njohjes me kornizën normative të kuadrove të reja në Shoqatën Nacionale

## Rezultatet e pritura

- Ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit nacional në favor të Kryqit të Kuq në përputhje me mandatin dhe misionin dhe vizionin e tij
- Miratimi i akteve të reja normative dhe ndryshimi i atyre ekzistuese në përputhje me ndryshimet më të fundit në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe
- Aftësimi i sekretarëve dhe punonjësve të Shërbimit Profesional në të gjitha nivelet e organizimit përdorimin e duhur dhe respektimin e akteve normative



## PRIORITETET E ZHVILLIMIT PËR VITIN 2020

1. Forcimi i integritetit të Organizatës për të qenë një faktor i fuqishëm dhe efektiv lokal dhe partner i respektuar në shtet.
2. Promovimi dhe mbështetja e një shoqërie më gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe kohezive dhe harmonizimi i qasjeve humanitare për përballimin e sfidave.
3. Forcimi i aftësive të zvogëlimit të rezikut, veprimi dhe reagimi i hershëm ndaj krizës, duke ndërtuar kapacitete të forta lokale të gatishmërisë dhe reagimit ndaj katastrofave.
4. Inkurajimi i shëndetit dhe mirëqenies pozitive, sociale, mendore dhe fizike dhe zvogëlimi i përjashtimit social, vetmisë, vështirësive shëndetësore dhe situatave të vështirësive sociale të grupeve të ndryshme të synuara.



## ZHVILLIMI ORGANIZATIV

Një shoqatë nationale që është e përgatitur të përgjigjet në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore ndaj sfidave humanitare të popullsisë së prekshme, duke shijuar besimin e partnerëve të saj dhe grupeve të synuara, është një objektiv kryesor i shoqatës nacionale për periudhën e ardhshme. Për të përbushur këtë përcaktim është para së gjithash e domosdoshme të mbash hapin me zhvillimin e mjedisit, të marrësh para-sysh ndikimin e teknologjisë digitale, të identifikosh mundësitet e partneritetit dhe mbledhjen e fondeve në kohën e duhur, ose shkurtimisht të jesh gjithnjë një hap përpara në planifikim dhe gjithmonë aty kur është e nevojshme.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet nacionale në fushën e programeve të parandalimit dhe reagimit ndaj situatave eventuale urgjente do të jetë prioritet në vitin e ardhshëm 2020. Me Ministrinë e Vëtëqeverisjes Lokale dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut do të intensifikojmë bashkëpunimin për të siguruar udhëzime për zhvillimin lokal të nismave dhe mbështetjes.

**Qëllimi kryesor: Përmirësimi i aftësive të Organizatës për të ofruar shërbime të qëndrueshme relevante, të përshtatura për mjedisin përmes një rrjeti të organizatave komunale dhe nismave vullnetare për kategoritë e prekshme të popullsisë.**

### Aktivitetet:

**Inovacioni dhe forcimi i rolit në ofrimin e shërbimeve të njoershme.** Të vepruarit për t'u përgjigjur nevojave humanitare të popullsisë së prekshme është baza e veprimit të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Duke ndjekur primin e një shoqate të fortë nacionale të certifikuar, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut do të zhvillojë novacionin dhe forcimin e shpërndarjes së shërbimeve në kuadër të aftësimit të popullsisë për ndihmën e parë, zhvillimin e një rrjeti të shpëtuesve të ujit dhe malit, zhvillimin e shërbimeve për kujdesin e personave të moshuar dhe të pafluqishëm, asistentë personalë për personat me aftësi të kufizuara, promovimin e sipërmarrjes sociale, ndihmën e parë psikologjike dhe mbështetjen psikosociale për individë dhe organizata të përfshira gjatë situatave urgjente, nisma novatore për mbështetje humanitare lokale të një individi ose grupi të synuar, promovim të edukimit joformal të parandalimit dhe mbrojtjes, etj. Ndërtimi i një organizate të besuar të përbërë nga aktorë të fortë lokalë dhe një rrjet i shpërndarë vepimesh do të jetë një parakusht i fortë për implementimin më të suksesshëm të qëllimeve të përcaktuara.

**Planet e zhvillimit lokal.** Zbatimi i aktiviteteve vullnetare relevante për nevojat humanitare të popullsisë, me cilësi dhe shtrirje të përshtatshme përfituesit, është karakteristikë e një organizate të fortë komunale të Kryqit të Kuq. Në vitin 2020 do

të fillojë të zbatohet metodologjia për vlerësimin e aktiviteteve të organizatave komunale të Kryqit të Kuq/Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe identifikimin e aspekteve pozitive dhe negative të punës, me qëllim të sigurimit të informacionit për ndërmarrjen e masave të zhvillimit për të bërë më të suksesshme punën e Shoqatës Nacionale në të gjitha nivelet organizative që do të iniciojnë përqatitjen e planeve të zhvillimit lokal.

**Forcimi i kapaciteteve të organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit.** Përmirësimi i kapaciteteve për mbledhjen e fondevë dhe zhvillimi i partneriteteve efikase me institucionet dhe organizatat lokale dhe rajonale do të jetë prioritet për mbështetjen e Zyrës Qendrore për të gjitha degët lokale. Përdorimi i softuerit të dedikuar të Kryqit të Kuq të RMV-së, kornizës normale të azhurnuar, përvojave dhe praktikave pozitive në punën e projektit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore janë vetëm disa nga temat që do të janë objekt i trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve në të gjitha nivelet e organizatës.

**Një rrjet efikas për përgjigje të koordinuar ndaj nevojave të popullsisë së prekshme.** Në përputhje me parimin e Unitetit, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut vepron në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për të pasur një qasje të ekuilibruar dhe të harmonizuar për tërë popullsinë, të gjitha organizatat komunale dhe Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit do të përpilen të marrin udhëzime të qarta dhe mbështetje në implementimin e aktiviteteve të programit në kohë të duhur dhe në mënyrë të barabartë. Për bashkëpunim më efikas do të iniciohen takimet rajonale dhe nacionale ku struktura menaxheriale dhe udhëheqëse do të mund të ndajnë përvoja, të iniciojnë aktivitete të përbashkëta ose të kontribuojnë në zhvillimin e politikave nacionale.

**Bashkëpunimi i partnerëve.** Partnerizimi me institucionet, organizatat në nivelin lokal, nacional dhe sektorin e korporatave është një segment me

vëmendje të veçantë. Redaktimi i praktikave të miratimit me bashkëpunimit me institucionet nacionale në vend duke nënshkruar marrëveshje dhe memorandume mirëkuptimi janë dëshmuar të jenë një parakusht i mirë për bashkëpunim dhe respekt të ndërsjellë. Kjo qasje do të fillohet të zbatohet edhe në nivelin lokal. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shoqatave civile që veprojnë në programe të njëjta ose të ngjashme dhe në të njëjtën kohë respektojnë parimet e Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

**Fondi i Zhvillimit të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.** Me ndryshimet në Ligjin e Kryqit të Kuq dhe politikat e paraqitura për punën e projekteve, hapet një mundësi për të mbështetur projektet e zhvillimit të iniciuara nga Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit. Përmes një formati të përcaktuar posaçërisht dhe një mekanizmi të rregulluar të përgjedhjes, monitorimit dhe vlerësimit, nga ky vit Organizatat komunale të Kryqit të Kuq do të jenë në gjendje të paraqesin iniciativat e tyre në Zyrën Qendrore dhe të forcojnë dhe zhvillojnë në mënyrë të konsiderueshme kapacitetet e tyre për të përmirësuar performancën dhe rezultatet e punës aktuale.

**Strategjia 2030.** Këtë vit, Kryqi i Kuq i RMV-së do të miratojë Strategjinë e re 2030 e cila po përgatitet në bazë të kornizës strategjike të Federatës Ndërkom-bëtare dhe nevojave të identikuara të zhvillimit të Organizatës për dhjetë vitet e ardhshme. Strategjia e re është në përpunim me parimet dhe vlerat tonë humanitare, bazuar në historinë e gjatë dhe unikë të Lëvizjes, me angazhimin për të përbushur gjithmonë nevojat me prioritet të grupeve të prekshme të synuara, në mënyrë të përkushtuar, të pavarur, të paanshme dhe me anë të veprimit neutral. Strategjia përcakton udhëzime për veprim në dekadën e ardhshme kur priten shumë ndryshime në mënyrën se si jetojmë dhe në llojet e krizave dhe prekshmërisë me të cilat ka të ngjarë se do të përballemi. Strategjia 2030 gjithashtu duhet të na sigurojë një koncept të ri të udhëheqjes dhe vendimmarrjes në nivelin lokal - ku komunitetet lokale do të jenë qendra e ndryshimeve tonë.

## **Rezultatet e pritura**

- Mjete novatore të zhvilluara për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për grupet e synuara.
  - Efikasitet i përmirësuar në punën e Organizatave Komunale dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit.
  - Bashkëpunim i përmirësuar me institucionet relevante në nivel lokal dhe nacional dhe projekte të zbatuara për zhvillimin lokal të organizatave komunale.
  - Një plan i zhvillimit i miratuar i Shoqatës Nacionale për dekadën e ardhshme.



## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Zhvillimi i bashkëpunimit me komponentët e Lëvizjes, si dhe me organizatat e tjera, mund të kontribuojë në zhvillimin e mëtutjeshëm të cilësisë së shërbimit si inovacione në funksionim dhe forcim të kapaciteteve të qëndrueshmërisë së programeve që zbatohen. Për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga fondet evropiane, zhvillimi i bashkëpunimit dypalësh do të synojë monitorimin dhe mbledhjen e përvojave nga Shoqatat Nacionale dhe organizatat që kanë praktikë pozitive në punën e projektit.

**Qëllimi kryesor:** Marrëdhënie të forcuara të partneritetit me komponentët e Lëvizjes dhe organizata të tjera për të përmirësuar kapacitetin e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës për grupet e synuara.

### Aktivitetet

**Mbështetja e aktiviteteve programore të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.** Në kuadër të veprimit të programit, Shoqata Nacionale do të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me organizatat partnere në drejtim të implementimit të përbashkët të projekteve ekzistuese, përgatitjen e aplikacioneve të reja të përbashkëta të projektit dhe organizimin e takimeve, ushtrimeve dhe simulimeve. Me mbështetjen e Kryqit të Kuq Austriak dhe Zviceran, Kryqi i Kuq do të vazhdojë implementimin e aktiviteteve për përkrahjen e të moshuarve, ndërsa me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Bullgar planifikojmë të zbatojmë ushtrime dhe simulime të përbashkëta për përgatitjen dhe reagimin ndaj katastrofave. Në fushën e sigurisë së ujit, do të mbahen trajnime të përbashkëta me Kryqin e Kuq Bullgar, dhe trajnime për ujë dhe sanitet do të mbahen me mbështetjen e Kryqit të Kuq Austriak - Shtaer.

### Rezultatet e pritura

- Implementimi i projekteve dhe sigurimi i mbështetjes dhe shërbimeve për kategori të ndryshme të synuara.
- Përvetësimi i njohurive dhe shkatërsive të reja për implementimin efikas të aktiviteteve të programit të Shoqatës Nacionale.
- Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh me shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në nivel nacional dhe lokal.

**Marrëveshjet e rinovuara të bashkëpunimit me shoqatat nacionale partnere.** Do të fillohet rinovimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq nga Austria, Norvegjia dhe Gjermania. Theksi në marrëveshjet do të jetë në zhvillimin e projekteve të përbashkëta që janë identifikuar si praktika të mira në shoqatat nacionale, qasjen në fondet e arritshme të mbështetjes dhe mbështetjen e drejtëpërdrejtë të nismave të projektit. Do të rekomandohet krijimi i partneritetve në nivelin lokal.

**Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq.** Parasikohet vendosja e bashkëpunimit formal lokal të 3 organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RMV-së me degë të Kryqit të Kuq Italian, 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të RMV-së me 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të Serbisë, 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të RMV-së me 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të Shqipërisë dhe 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të RMV-së me 2 organizata komunale të Kryqit të Kuq të Bullgarisë.

**Fqinjët ndihmojnë të parët.** Si anëtar i Rrjetit Rajonal të Mbështetjes së Ndërsjellë "Fqinjët Ndihmojnë Të Parët", Kryqi i Kuq i Maqedonisë së Veriut do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me shoqatat nacionale në rajon dhe do të jetë i përgatitur të përgjigjet në mënyrë të duhur në rast të një situate të jashtëzakonshme ose katastrofe. Për të pasur një veprim më efikas dhe një qasje të koordinuar kur të ketë nevojë për veprim të përbashkët, do të iniciohet shkëmbimi i përvojave, praktikave, veglave dhe organizimi i simulimeve dhe ushtrimeve që do të përfshijnë të gjithë aktorët relevantë në Rajon.



## MENAXHIMI VULLNETAR DHE ANËTARËSMI

Vullnetarizmi është një mjet i rëndësishëm për përfshirjen sociale dhe është një mënyrë e rëndësishme për të ndërtuar kapitalin shoqëror në komunitete. Kjo është arsyja pse ne vazhdimisht po përpinqemi t'i frymëzojmë njerëzit të vlerësojnë vullnetarizmin dhe angazhimin në Kryqin e Kuq. Vullnetarizmi është themeli për përparimin e komuniteteve. Ai inkurajon njerëzit të jenë qytetarë të përgjegjshëm. Vullnetarët tanë ndihmojnë njerëzit në nevojë dhe punojnë për një botë ku ka më shumë humanizëm dhe paqe. Vullnetarët ndajnë kohën e lirë, njohuritë dhe shkakhtësitë e tyre rregullisht ose kohë pas kohe në planin e sigurimit të veprimtarive humanitare, mobilizimin e burimeve, mbështetjen administrative, udhëheqjen ose mbështetjen këshilluese.

Vullnetarizmi bazohet në parimin e vullnetarizmit, duke vepruar në të mirë të të tjera e pa kompensim financier. Si një mënyrë veprimi ka përfitime sociale dhe individuale. Vullnetarizmi gjithashtu ndihmon në ndërtimin e komuniteteve kohezive (ndërlidhëse), krijimin e besimit më të madh në mesin e qytetarëve dhe zhvillimin e normave të solidaritetit dhe reciprocitetit të

nevojshëm për një komunitet të qëndrueshëm. Nga ana tjetër, përmes vullnetarizmit, pasi mbarimit të arsimit për një individ hapet mundësia për të takuar njerëz të rinj, për të intensifikuar komunikimin dhe për të krijuar një qasje aktive ndaj jetës. Vullnetarizmi si model i funksionimit brenda shoqërisë krijon solidaritet nacional edhe në kohë të kushteve të favorshme ku grupe më të prosperuara shpesh kontribuojnë në mirëqenien e atyre që kanë nevojë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e vullnetarëve për realizimin e suksesshëm të veprimtarive programore, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdimisht përpinqet të përmirësojë cilësinë, standardet dhe kapacitetet e vullnetarëve, si dhe t'i mbajë ata në Organizatë duke krijuar një mjedis mikpritës dhe gjithëpërfshirës social. Ky mjedis i favorshëm nënkuption sigurimin e trajnimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rregullt të vullnetarëve, si dhe njohjen e kontributit të tyre; të siguruarit, sigurimin e pajisjeve të duhura dhe mbështetjen psikosociale; dhe sigurimin e mbështetjes organizative për krijimin e strukturave lokale relevante për detyrat që duhet të kryhen nga vullnetarët.

Meqë tendencat e jetës vazhdojnë të ndryshojnë në lidhje me vullnetarizmin e njerëzve, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut po punon për të miratuar politika sociale dhe ekonomike që promovojnë fuqimisht vullnetarizmin në vend.

Prioriteti kryesor i këtij viti do të jetë rritja e numrit të vullnetarëve të aftësuar përmes prezantimit të metodave novatore të përmirësimit, trajnimit dhe angazhimit të vullnetarëve duke përdorur përvojat dhe veglat pozitive të Rrjetit Evropian të Zhvillimit të Vullnetarizmit të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sigurimit të numrit të kërkuar minimal të anëtarëve (14.000, në përputhje me numrin individual të anëtarëve për secilën OKKK të përcaktuar në metodologjinë e numrit të kërkuar për anëtarët e OKKK-ve) në disa organizata komunale duke përshtirë aktivitete të inkurajimit të anëtarësimit dhe sigurimin e numrit të kërkuar të anëtarëve.

**Qëllimi kryesor:** Sigurimi i mbështetjes për grupet e synuara në komunitetet lokale përmes vullnetarëve dhe anëtarëve të fryshtuar dhe të mobilizuar të Organizatës.

## Aktivitet

Gjatë vitit, Shoqata Nacionale përmes organizatave komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit do të vazhdojë të investojë në vullnetarët, duke përmirësuar njohuritë e tyre përmes pjesëmarrjes së tyre në trajnime të ndryshme të specializuara të organzuara përmes programeve të Organizatës. Theks i veçantë do të vihet në organizimin e trajnimeve të menaxhimit të vullnetarëve për trajnimin e personave që janë përgjegjës për promovimin e vullnetarizmit në nivelin lokal. Gjithashtu gjatë vitit do të organizohet trajnimi për orientuesit dhe do të monitorohet puna e orientuesve të Kryqit të Kuq të cilët kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e vullnetarizmit dhe orientimin e vullnetarëve të rinj në nivelin lokal.

## Rezultatet e pritura:

- Numri i rritur i vullnetarëve të aftësuar për të përbushur nevojat parësore të popullsisë së prekshme
- Interesi i shtuar për anëtarësim në Organizatë për të ofruar mbështetje publike për aktivitetet e Kryqit të Kuq.
- Baza e azhurnuar e të dhënave të vullnetarëve dhe anëtarëve të Organizatës.
- Kapaciteti i përmirësuar i vullnetarëve dhe anëtarëve të Organizatës përmes sigurimit të trajnimeve të përshtatshme për implementimin e aktiviteteve të Kryqit të Kuq.

Duke ecur në hap me zhvillimin e teknologjisë digitale, Organizata gjatë vitit do të përpinqet të bëjë një përparim pozitiv në aplikimin dhe përdorimin e aplikacioneve softuerike për rekrutimin, ndjekjen e punës dhe mbajtjen e vullnetarëve.

Inkurajimi i zhvillimit të vullnetarizmit në moshë të re do të jetë një angazhim thelbësor i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, do të rishikohet libri i lëndës Shoqëria Qytetare për klasën e shtatë ku është përshkruar puna e Kryqit të Kuq dhe brenda programit të rregullt shkollor të promovohen vlerat e humanizmit dhe vullnetarizmit. Zhvillimi i mënyrave të reja të organizimit të punës vullnetare brenda programeve do të jetë baza përritjen e numrit të vullnetarëve, dhe përmes tyre rritjen e vëllimit të përfituesve të mbuluar dhe shërbimeve të ofruara.

Tradicionilist, më 5 dhjetor, në nivel nacional do të mbahet një ngjarje e dhënes së mirënjohjeve për individët dhe format e organizimit të punës vullnetare që kanë arritur rezultatet më të mira gjatë vitit të kaluar, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Vullnetarizmit - 5 Dhjetorin.

Një nga angazhimet kryesore vazhdon të jetë ndërmarrja e aktiviteteve për të inkurajuar anëtarësimin të reja në Organizatë në nivelin lokal, si një nga parakushtet më të rëndësishme për ofrimin e mbështetjes publike për aktivitetet e Organizatës. Aktivitetet në këtë fushë do të ndërmerren në bashkëpunim me Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq në mënyrë që të sigurohet angazhimi i vazhdueshëm i Organizatës së përgjithshme për të rritur numrin e anëtarëve në përputhje me metodologjinë për numrin e kërkuar të anëtarëve në organizatat komunale të Kryqit të Kuq, duke siguruar në këtë mënyrë sasinë optimale të anëtarëve përfunksionimin e Organizatës.

# MENAXHIMI I PROJEKTIT DHE MOBILIZIMI I FONDEVE NGA SEKTORI I KORPORATAVE

Për të siguruar më shumë fonde për zbatimin e programeve përmes burimeve të mundshme të finançimit, Kryqi i Kuq i RMV-së planifikon të forcojë fushëveprimin e punës përmobilizimin e fondeve. Aktivitetet e programit pritet të realizohen përmes projekteve, dhe për këtë qëllim do të punojmë përmirësuar sistemin e brendshëm në të gjitha nivelet e Organizatës në mënyrë që të sigurojmë donatorë dhe sponsorë, vendas dhe ndërkombëtar. Projektet do të zhvillohen në bazë të nevojave organizative, tendencave sociale në vend dhe nevojave të popullsisë. Një detyrë parësore për vitin 2020 do të jetë forcimi i kapaciteteve të OKKK-ve përgatitjen e projekteve dhe përdorimin e fondeve në dispozicion.

Në vitin e ardhshëm, OKKK-të dhe KKQSH-ja do të marrin mbështetjen e duhur për zhvillimin e kapaciteteve për përgatitjen dhe implementimin e projekteve, dhe kjo do të paraprihet nga një analizë e punës tashmë të bërë në fushën e punës së projektit. Fondet e BE-së dhe mundësítë e përdorimit të tyre nga ndihma e para-pranimit dhe instrumentet tjera financiare të BE-së do të jenë një objektiv kryesor i realizimit. Përmes monitorimit të rregullt të thirrjeve të hapura, bazës së të dhënavë të përgatitur dhe projekteve të paraqitura në nivelin e Organizatës, aplikimi do të realizohet në bazë të planifikimit të duhur, analizës së bërë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me sektorin e korporatave dhe krimjimi i partneriteteve strategjike me kompanitë është gjithashtu një segment i rëndësishëm i angazhimit të Shoqatës Nacionale për të siguruar mbështetje për zbatimin e projekteve dhe aktivitetave të programit. Kryqi i Kuq në vendin tonë njihet si partner serioz i institucioneve dhe kompanive që bashkërisht investojnë në përmirësimin e jetës së popullsisë. Për këtë qëllim, përmes iniciativave të duhura, do të vazhdojnë të bëhen përpjekje për të promovuar përgjegjësinë sociale të korporatave për ofrimin e një mbështetje efektive dhe avokimin e interesave të popullsisë së prekshme. Detyra parësore e punës me kompanitë me përgjegjësi shoqërore do të jetë prezantimi i shërbimeve të ofruara nga OKKK-të duke përgatitur një katalog të shërbimeve në dispozicion me të cilat do të arrihen më tej marrëveshje afatgjata të financimit për një shërbim të veçantë.

**Qëllimi kryesor:** Përgatitja e iniciativave të projektit dhe fondet e mobili-zuara për zbatimin e programeve për interesat e popullsisë

# Aktivitetet

- Krijimi i një baze të dhënash të projekteve të aplikuara dhe të përgatitura nga KKRM, KKQSH dhe OKKK
  - Organizimi të paktën një herë në muaj i takimeve të planifikimit, përgatitjes dhe koordinimit të projekteve të sektorit, dhe minimum gjashtë në nivel nacional për të mbështetur udhëheqësit e sektorëve dhe sekretarët
  - Pjesëmarrje në të paktën 5 ngjarje publike me interes të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të aplikimit për projektet e thirrjeve në dispozicion
  - Përgatitja e pyetësorëve dhe analiza e aftësive të Shoqatës Nacionale për përgatitjen e projekteve nga burime të BE-së
  - Trajnim i organizatave komunale të Kryqit të Kuq për përgatitjen e projekteve dhe përgatitja e 15 projekteve të OKKK-ve - grante të vogla.
  - Përgatitja dhe paraqitja e aplikacioneve për të paktën 4 projekte të finançuara nga BE.
  - Promovimi i vlerave humane për kompanitë, në të njëjtën kohë duke potencuar përfitimet e një partneriteti me Kryqin e Kuq, është një nga format e rëndësishme të krijimit të partneriteteve për implementimin e aktiviteteve të përbashkëta të komunitetit. Gjatë vitit do të mbahet takime me 10 kompani për krijimin dhe forcimin e partneritetit.
  - Kryqi i Kuq i RMV-së do të vazhdojë të zhvillojë bashkëpunimin e frytshëm me odat ekonomike në vend me qëllim të implementimit të nismave të përbashkëta që synojnë promovimin e përgjegjësisë shoqërore të korporatave të kompanive për mbështetjen e tyre në zbatimin e programeve të dedikuara për grupet e synuara në nevojë të popullsisë. Katër takime diseminimi dhe diskutime në panel do të mbahen me anëtarët e odave për të promovuar Katalogun e Shërbimit të Shoqatës Nacionale.
  - Për të inkurajuar partneritetet strategjike për implementimin e programeve të përbashkëta sociale të dobishme për shoqërinë, do të organizohet një takim partneriteti i cili është bërë tradicional dhe është duke u mbajtur tanimë 10 vjet me radhë me përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe sektorit të korporatave. Për këtë qëllim, do të përgatitet një katalog projekti që do t'u ofrohet partnerëve dhe donatorëve për mbështetje dhe përfshirje në implementimin e përbajtjes së projektit.

## **Rezultatet e pritura:**

- Kapaciteti i forcuar i organizatave komunale të Kryqit të Kuq për të rritur fondet përmes punës së projektit
  - Fonde të siguruara për aktivitetet e Shoqatës Nacionale përmes fondeve të BE-së, sektorit të korporatave dhe fondeve të tjera në dispozicion



## PROGRAMET SOCIALE - HUMANITARE

Programet social-humanitare synojnë të kontribuojnë në mbrojtjen e dinjitetit dhe në zvogëlimin e prekshmërisë së personave që përballen me rreziqe të caktuara shoqërore. Përmirësimi i burimeve njerëzore të Organizatës, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore përfituesit, si dhe forcimi i kapaciteteve të grupeve të cenueshme të popullsisë për një integrim më të mirë shoqëror në komunitete, do të janë aktivitete parësore për Shoqatën Nacionale për të vepruar në programe sociale dhe humanitare. Është me shumë rëndësi në të ardhmen të krijojmë partneritete me institucionet qeveritare, sektorin civil, komunitetin e biznesit për të ofruar mbështetje për zhvillimin e komuniteteve në nevojë. Në punën tonë do të përdorim një qasje pjesë-marrëse me përfshirje të menjëherëshme aktive të popullsisë së prekshme në mënyrë që të kontribuojmë në një spektër të gjerë përgjigjesh të mundshme ndaj sfidave të identikuara të komunitetit. Zbatimi i programeve do të përfshijë grupe të ndryshme të synuara, siç janë qytetarët e mosuar, personat me aftësi të kufizuara, familjet në rezik shoqëror, komunitetet në nevojë, të rinjtë dhe popullsia e përgjithshme.

**Qëllimi kryesor:** Kontributi në uljen e varfërisë dhe përjashtimin social të grupeve të prekshme të popullsisë.

### Aktivitet

**Kujdesi dhe mbështetja e të mosuarve.** Kryqi i Kuq i RMV-së me mbështetjen e Kryqit të Kuq Austriak, organizatave dhe agjencive ndërkombëtare, si dhe me mbështetjen e partnerëve nga vendi, do të vazhdojnë të zhvillojë aktivitete projekti për kujdesin dhe mbështetjen e të mosuarve në shtëpi. Ofrimi i shërbimeve të duhura nga vullnetarët e Kryqit të Kuq dhe infermieret e angazhuara përmes Kryqit të Kuq do të

sigurojë mbështetje për plotësimin e nevojave parësore të të mosuarve të dobët në shtëpi. Gjatë vitit, përveç qendrës së ndihmës së personave të mosuar në shtëpi që funksionon përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, do të hapen edhe 4 qendra të reja përmes organizatave komunale të Kryqit të Kuq.

**Qendrat e kujdesit ditor dhe klubet për të mosuarit** janë një formë e organizuar e plakjes aktive dhe të shëndetshme që do të zhvillohet në Shoqatën Nacionale me mbështetjen e institucioneve të qeverisjes vendore dhe sektorit të korporatave. Katër qendrat e kujdesit ditor për të mosuarit që veprojnë përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatës Komunale të Kryqit të Kuq - Gazi Babë, si dhe katër klubet e personave të mosuar që menaxhohen nga Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq - Kriva Pallankë, Negotinë, Prilep dhe Veles janë shembuj pozitivë për të mosuarit që të përfshihen në mënyrë aktive në sfera të ndryshme të veprimit shoqëror. Një tjetër qendër e kujdesit ditor për të mosuarit do të hapet gjatë vitit.

**Trajnimë për kujdestarët e të mosuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.** Kryqi i Kuq i RMV-së është një organizatë e verifikuar që zbaton programe trajnimi për kujdestarë të personave të mosuar dhe të pafluqishëm. Trajnimet për kujdestarët do të organizohen përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq - Prilep, Ohër, Gostivar, Strugë, Negotinë, Strumicë. Synimi i Shoqatës Nacionale është shtrirja e programeve të trajnimit edhe në 5 organizata të reja komunale këtë vit sipas kushteve dhe kapaciteteve të organizatave. Me këtë trajnim të certifikuar, njerëzit fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca për të ofruar shërbime themelore shëndetësore dhe sociale në kushte shtëpiake për

njerëzit që për shkak të moshës, sëmundjeve kronike dhe shkaqe të tjera janë në gjendje të rraskapitjes dhe pamundësisë për t'u kujdesur përveten e tyre. Shërbimet janë të një natyre dhe forme të ndryshme dhe zëvendësojnë përkujdesjen institucionale dhe format e tjera të kujdesit të organizuar. Sipas Rregullores për certifikimin e Programeve të Qendrës së Edukimit për të Rritur, Kryqi i Kuq i RMV-së në vitin 2020 ka detyrim të verifikojë programin në të cilin do të futen përbajtje të reja përtëjta përmirësuar atë. Gjatë vitit do të aftësohen kujdestarë të rinj që do të ofrojnë shërbime cilësore përtëj moshuarit.

**Shërbimet sociale dhe shëndetësore përtëj moshuarit në kushte shtëpiake.** Përmes Qendrës së Kujdesit të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, kujdestarë të trajnuar janë angazhuar përtë ofruar shërbime për personat e moshuar dhe të pafuqishëm në Shkup. Shërbime të tillë gjithashtu do të hapen përmes 6 organizatave komunale të Kryqit të Kuq që do të kryejnë programe të verifikuara të trajnimit përtë kujdestarë. Për nevojën e ofrimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore përtë moshuarit në shtëpi flasin gjithashtu të dhënat nga një studim i kryer në vitin 2018 nga një agjenci e jashtme kërkimore, sipas të cilit 45.7% e personave të moshuar mbi 80 vjeç kanë nevojë për mbështetje shtesë në shtëpinë e tyre. (Hulumtimi u krye në 1004 të anketuar, të moshuar mbi 65 vjeç nga 8 rajone në Maqedoninë e Veriut, brenda projektit rajonal të finançuar nga Bashkimi Evropian përfshirjen sociale të personave të moshuar).

**Rrjeti "InkluzivaM" përfshirjen sociale të të moshuarve.** Me iniciativën e Kryqit të Kuq të RMV-së dhe Shoqatës "Humanost", në vitin 2016 u krijuar rrjeti "InkluzivaM" përfshirjen sociale të të moshuarve, në të cilin janë anëtarë Kryqi i Kuq i RMV-së dhe 8 shoqata qytetare. Në përputhje me strategjinë e avokimit përfshirjen sociale të të moshuarve të miratuar nga anëtarët e rrjetit, Kryqi i Kuq do të kontribuojë në hapjen dhe zhvillimin e shërbimeve sociale përtë moshuarit përmes 6 Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq, si dhe aktivitetet përtë rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe ndikimet pasuese në proceset e vendimmarrjes përfshirjen sociale të të moshuarve.

**Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve dhe Java e Kujdesit ndaj të Moshuarve** janë aktivitetet tradicionale që do të shënohen me qëllim të ngritisë së vetëdijes së popullsisë për realizimin e të drejtave të të moshuarve, si dhe kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme të të moshuarve. Aktivitetet edukative do të organizohen mbi tema me interes përtë moshuarit, aktivitetet rekreative dhe krijuese, si dhe aktivitetet përtë mbështetur qytetarët e moshuar në komunitete. Aktivitetet do të përfshijnë më shumë se 4.000 persona aktívë të moshës së tretë.

**Asistenca personale për personat me aftësi të kufizuara.** Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut është ofrues i shërbimeve të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara tanimë përtë tretin vit radhazi. Shërbimet më të përdorura janë shërbimet në komunitet, shtëpi, vend të punës dhe në procesin e arsimit të lartë. Kjo mënyrë e ofrimit të shërbimeve kontribuon në një shoqërizim më të madh dhe përfshirje të personave në komunitet përmes aktivitetave të ndryshme - individuale dhe të përbashkëta. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara do të vazhdojnë të ofrohen nga asistentë personalë. Ato janë të organizuara përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq - Manastir, Strugë, Strumicë, Gostivar, Negotinë dhe Kumanovë.

Kryqi i Kuq i RMV-së është një organizatë e verifikuar për zbatimin e programit të trajnimit për asistencë personale për personat me aftësi të kufizuara. Ato janë të organizuara përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe gjashtë organizatave komunale të Kryqit të Kuq. Gjatë vitit 2020 ky program do të zgjerohet në 5 organizata të reja komunale të Kryqit të Kuq ku ka kushte dhe kapacitete për verifikimin e Organizatës për zbatimin e tij.

Për të zhvilluar shërbime për personat me aftësi të kufizuara, Kryqi i Kuq i RMV-së do të krijojë një program të ri që do të verifikohet në Qendrën e Edukimit të të Rriturve dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

**Përmirësimi i shoqërizimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara** është një aktivitet i vazdueshëm i projektit i cili zbatohet në bashkëpunim me Entin e Veprimtarisë Sociale dhe mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve nga sektori i korporatave, përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq Veles, Prilep, Kavadar, Dellçevë, Dibër, Kërçovë dhe Gostivar. Do të organizohen aktivitetet për shoqërizimin e mbi 320 fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara nga qendrat e kujdesit ditor, të cilat do të përfshijnë vullnetarë të rinj të Kryqit të Kuq nga 8 komuna. Aktivitetet e projektit gjithashtu ofrojnë mbështetje psikosociale përfshirjen e familjet kujdestare në Shkup, Veles dhe Prilep. Gjatë vitit, aktivitetet e tillë do të zgjerohen me përfshirjen e 4 organizatave të reja komunale të Kryqit të Kuq.

**Politika për mbrojtjen dhe ofrimin e ndihmës humanitare përfshirjet, migruesit, personat e zhvendosur brenda vendit, të kthyerit dhe azilkërkuesit.** Për të krijuar një sistem për reagimin ndaj çështjeve të migracionit, Kryqi i Kuq i RMV-së do të zhvillojë një politikë përfshirjet, migruesit, personat e zhvendosur brenda vendit, të kthyerit dhe azilkërkuesit në vitin 2020. Politika do të përfshijë udhëzime përfshirjet, migruesve, informacion mbi të drejtat e migruesve, lidhjen, ndihmën, mbrojtjen dhe përfaqësimin humanitar përfshirjet, personat e zhvendosur brenda vendit, të

kthyerit dhe azilkërkuesit, ndërtimin e partneritetev për të mbështetur migruesit, mbështetjen me rastin e kthimit, përgjigjen ndaj nevojave të zhvendosjes së popullsisë dhe çështjeve të tjera që lidhen me migrationin.

### **Themeli i zhvillimit i sipërmarrjes sociale në**

**Shoqatën Nacionale.** Drejtuesi kryesor për promovimin e konceptit të ekonomisë sociale dhe ndërmarrjeve sociale është shoqëria civile, e mbështetur nga organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e donatorëve. Ndërmarrjet sociale janë shfaqur vitet e fundit si një fenomen i ri dhe shumë i rëndësishëm. Sipërmarrësia sociale përcaktohet si zbatim i vazhdueshëm i aktiviteteve ekonomike në kushte të caktuara të punës dhe punësim i grupeve kryesish të marginizuar të personave. Qëllimi është të gjenerojmë vlera shoqërore në mënyrë që komuniteti të përfitojë nga aktivitetet sipërmarrëse. Kryqi i Kuq i RMV-së filloi aktivitetet për promovimin e sipërmarrjes sociale, janë edukuar një pjesë e strukturave të disa organizatave komunale të Kryqit të Kuq. Organizata Komunale e Kryqit të Kuq Manastir siguroi mbështetje për hapjen e një ndërmarrje sociale. Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit po punon intensivisht në zbatimin e aktiviteteve ekonomike të destinuarë për qëllime sociale, siç janë Qendra "Solferino" në Strugë, Projekti "Kopsa", Qendra e Kujdesit për Personat e Moshuar dhe Të Pafuqishëm. Kryqi i Kuq i RMV-së, me mbështetjen e fondeve Evropiane, do të ndërmarrë nisma për promovimin e konceptit të sipërmarrjes sociale në Shoqatën Nacionale, duke organizuar mësime të përbashkëta dhe duke siguruar mbështetje për menaxhimin e ndërmarrjeve sociale, duke ndihmuar ekipet që synojnë krijimin e një ndërmarrje shoqërore (stërvitje, mentorim, planifikim biznesi dhe ndikim, etj.); duke u lidhur me ndërmarrjet shoqërore në vend dhe ndërkombëtarisht për të shkëmbyer praktikat e mira, veglat dhe metodat e punës, etj.

**Sfida për një zgjidhje novatore për të sigruar - "Ushqim për të gjithë"** është një projekt i mbështetur financiarisht nga Fondi i Inovacionit dhe Zhvillimit të Teknologjisë. Qëllimi i projektit është të krijojë një zgjidhje të qëndrueshme që do të sigurojë në mbarë vendin një sistem që do të shfrytëzojë tepricat e tregut për të sigruar ushqime nutritive për kategori të mëdha dhe të ndryshme të qytetarëve të rezikuar në aspektin social që kanë nevojë për to. Modeli i propozuar do të pasqyrojë realitetin e mundësive të tepricës së ushqimit në vend, për të përmbrushur nevojat e kategorive të prekshme të qytetarëve nga rajone të ndryshme, së bashku me kapacitetet dhe nevojat për inves-

time në terren në ndërtimin e kapaciteteve përmes ristrukturimit të projektit "Kuzhinat Popullore" dhe shfrytëzimi i të gjithë potencialit ekzistues të organizatave të ndryshme.

### **Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore.**

Gjatë vitit do të zbatohen aktivitete parandaluese që synojnë ndërgjegjësimin e popullsisë së re për të njohur mënyrat me të cilat të rinjtë mund të përfshihen në trafikimin e qenieve njerëzore dhe vetëmbrojtjen e tyre. Kryqi i Kuq do të përfshihet në mënyrë aktive në shënimin e Ditës Evropiane dhe Javës së Luftimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të koordinuara nga Komisioni Nacional për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionin e Paligjshëm të RMV-së. Me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, trajnerë të rinj do të trajnohen për të zhvilluar një program parandalues kundër trafikimit të qenieve njerëzore në kontekstin e migracionit. Trajnimi do të përfshijë vullnetarë të rinj nga Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit dhe 4 organizata komunale të Kryqit të Kuq. Një projekt për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore do të zbatohet me mbështetjen e Qeverisë së RMV-së, i cili do të edukojë 30 vullnetarë të rinj të Kryqit të Kuq në Manastir, Prilep, Kumanovë, Koçanë, Kërçovë dhe Resnjë për mbajtjen e punëtorive për edukimin e bashkëmoshatarëve të të rinjve përritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Mësimet parandalues do të përfshijnë mbi 1200 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

**Aksionet humanitare, fushatat për të mbështetur familjet në rrezik shoqëror.** Për të rritur kapacitetin e Shoqatës Nacionale për t'u përgjigjur sfidave të plotësimit të nevojave specifike të grupeve të prekshme të synuara në komunitete, 2 aksione të mëdha dhe fushata humanitare do të organizohen gjatë vitit për shënimin e Javës së Solidaritetit dhe Javës së Luftës Kundër Urisë. Aksionet do të ofrojnë ushqim, veshmbathje, ndihmë higjienike për njerëzit e prekshëm që kanë nevojë për këtë lloj mbështetje. Përveç këtyre dy aksioneve tradicionale, qytetarët dhe të gjithë të interesuarit gjatë gjithë vitit mund të dorëzojnë donationet e tyre në 33 organizata komunale të Kryqit të Kuq dhe në Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit, ose të dhurojnë mjete në Fondin e Solidaritetit ose përmes telefonave celularë të publikuar në faqen e internetit të Kryqit të Kuq të RMV-së

## **Rezultatet e pritura**

- Janë zhvilluar shërbime sociale dhe janë shpërndarë shërbime cilësore dedikuar për grupet e synuara në nevojë.
- Është ngritur ndërgjegjësimi publik për nevojën që popullsia e ceneshtue të përfshihet në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.



## GATISHMËRIA DHE REAGIMI NË KATASTROFA

Për të ofruar ndihmë të shpejtë dhe efektive humanitare, aktivitetet e Shoqatës Nacionale në fushën e gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa synojnë sigurimin e azhurnimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore në të gjitha OKKK-të dhe KKQSH-në. Aktivitetet programore të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa janë gjithashtu pjesë e politikave dhe reagimit nacional, duke rezultuar në një bashkëpunim shumëvjeçar të suksesshëm me të gjitha subjektet përgjegjëse në këtë fushë, siç janë njësítë e vetëqeverisjes lokale, organizatat e punës, institucionet arsimore, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Qendra e Menaxhimit të Krizave, Armata, Akademia Ushtarakë dhe aktorë të tjerë aktivë, vendas dhe të huaj.

Në vitin 2020, detyra parësore në fushën e gatishmërisë dhe reagimit ndaj katastrofave është vënia në funksion e Qendrës Operative për Gatishmërinë dhe Reagimin në Katastrofa të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe operacionalizimi i Fondit të Gatishmërisë dhe Reagimit në Katastrofa të KKRMV-së (dedikuar për përmirësimin e kapaciteteve të OKKK /KKQSH në nivel lokal në fushën e gatishmërisë: trajnime, pajisje dhe sigurim të furnizimeve të caktuara me ndihma humanitare: ushqim, produkte higjenike, etj).

**Qëllimi kryesor:** Kapaciteti i forcuar për zvogëlimin e rrezikut, paralajmërimi i hershëm dhe reagimi ndaj krizave përmes strukturave të forta lokale dhe kapaciteteve për gatishmëri dhe reagim ndaj katastrofave.

### Aktivitetet

- Vënia në funksionim e Qendrës Operative që ndodhet në ambientet e Qendrës Logistike të KKRMV-së në Monin Potok - Shkup. Në këtë Qendër, përmes procedureve standarde operative (PSO) të reagimit ndaj katastrofave, në kohën e duhur dhe në mënyrë të koordinuar do të organizohen të gjitha veprimet në rast katastrofash. Zbatimi i PSO-ve do të sigurojë një përgjigje të sinkronizuar dhe parandalim më të mirë në gatishmërinë dhe reagimin e të gjitha OKKK-ve dhe KKQSH-së. Qendra Operative do të jetë e hapur për bashkëpunim të mëtejshëm me të gjitha institucionet me të cilat Shoqata Nacionale bashkëpunon me sukses.
- Fondi i Gatishmërisë dhe Reagimit në Katastrofa i KKRMV-së. Në vitin 2020, do të fillojë funksionimi i Fondit të Gatishmërisë dhe Reagimit në Katastrofa për të përmirësuar kapacitetin e OKKK/KKQSH në nivelin lokal në fushën e gatishmërisë (trajnimit, pajisjeve) dhe sigurimit të furnizimeve të caktuara humanitare (ushqim, produkte higjenike etj).
- Mbështetje për tri OKKK për formimin e ekipeve të gatishmërisë dhe reagimit ndaj katastrofave.
- Implementimi i platformës NIKS në bashkëpunim me Qendrën e Menaxhimit të Krizave, do të organizohen tre ushtrime simuluese (ushtrime shkollore në 3 rajone). KK do të marrë pjesë dhe do të jetë pjesë e organizimit të një stërvitje ndërkombëtare të NATO-s në bashkëpunim me Qendrën e Menaxhimit të Krizave.
- Sipas Memorandumit të ri të rishikuar dhe të nënshkruar të bashkëpunimit me Armatën do të organizohet të paktën një takim në vit me qëllim të promovimit të bashkëpunimit me temën Armata dhe Kryqi i Kuq gjatë viteve të kaluara.

- Rritja e ndërgjegjësimit publik në institucionet arsimore përmes zbatimit të Projektit të Shkollave dhe Kopshteve të Sigurta, i financuar nga Programi ERASMUS+, i cili inicioi përgatitjen e një dokumenti të avokatisë për zvogëlimin e rrezikut të katastrofave në nivelin nacional, rajonal dhe evropian, përgatitjen një kompleti materialesh/katalog resursesh për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat dhe vendosjen e një platforme onlajn për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat në të paktën 2 deri në 5 institucionë arsimore me trajnime të standardizuara për rreth 200 personel mësimor.
- Për të avancuar politikat e zvogëlimit të rreziqeve, Organizata do të zhillojë në mesin e popullsisë fushata edukative, edukime dhe pyetësorë për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike që në të ardhmen mund të shkaktojnë ngjarje më të shpeshta ekstreme si përbërje, thatësira, etj. valë të ftohta dhe të nxehtit dhe katastrofa të tjera.
- Në vitin 2020 do të përgatitet një plan operativ 2020-2022 për bashkëpunim me Kryqin e Kuq Austriak - Kryqin e Kuq të Qytetit Shtaer, i cili do të përfshijë një program të përbashkët dhe një plan trajnimi përvullnetarët në fushën e ujit, sanititetit dhe promovimit të higjienës në rast të katastrofave, të cilët do të jenë të aftësuar për të reaguar në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Me qëllim të forcimit të qendrave profesionale për sigurinë e ujit këtë vit do të punohet në avancimin e veprimtarisë duke rishikuar rregulloret ekzistuese, dhe do të organizohen tre kurse për shpëtuesit dhe instruktorët e ujit për 30 shpëtimtarë në mënyrë që të rriten kapacitetet.
- Në fushën e aktiviteteve të sigurisë malore, Kryqi i Kuq do të fillojë një analizë të nevojës për miratimin e Ligjit për shpëtimin malor, e cila përfshin një seri të proceseve këshilluese, analizën e dokumenteve të përshtatshme dhe shkëmbimin e përvojave me shoqatat fqinje ku është në funksion ky ligj.
- Ekipi i zyrës qendrore do të vazhdojë të sigurojë mbështetje logjistike për ekipet dhe stacionet e shpëtimit malor të Ohrit (OKKK Ohër) dhe Shkupit (Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit) vazhdimesht gjatë gjithë viti gjatë fundjavave, festave, ngjarjeve, dhe në bazë të thirrjeve.
- Kryqi i Kuq Veles tradicionalisht merr pjesë në organizimin e maratonës së notit në Ligenin Mladost-Veles, me mbështetjen e ekipit të Kryqit të Kuq të RMV-së i cili në vitin 2020 do të përfshijë një ekip të Kryqit të Kuq të Republikës së Bullgarisë me qëllim të shkëmbimit të përvojave.
- Përgatitja e bazës së të dhënave për të gjithë personelin e trajnuar në fushën e gatishmërisë dhe reagimit ndaj katastrofave, me qëllim të avancimit të kapaciteteve të OKKK-ve dhe KKQSH-së.
- Në vitin 2020 në kuadër të projektit "Fqinjët të parët ndihmojnë" do të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Kryqin e Kuq Bullgar dhe shoqatat e tjera nacionale të përfshira në këtë aksion për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa, i cili është paraparë në marrëveshjen e bashkëpunimit.



## Rezultatet e pritura:

- Fuqizimi i kapaciteteve të Shoqatës Nacionale për gatishmëri dhe veprim në katastrofa.
- Është rritur ndërgjegjësimi publik për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike dhe është forcuar kapacitetit i Shoqatës Nacionale për zbatimin e aktiviteteve të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.
- Është përmirësuar sistemi i zbatimit të edukimit dhe trajnimit për zvogëlimin e rreziqeve nga katastrofat, ndihmës së parë dhe mbështetjes psikosociale për nxënësit e shkollave dhe fëmijët e kopshteve në rast katastrofash.
- Kapacitete të forcuarat të Shoqatës Nacionale në fushën e ujit dhe sanititetit dhe promovimi i higjienës, sigurisë së ujit dhe sigurisë malore.



## PROGRAMET PARANDALUESE SHËNDETËSORE

Vizioni i Shoqatës Nacionale është të kontribuojë për një jetë të shëndetshme dhe të sigurt për të gjithë, synojmë të zvogëlojmë vdekjet dhe sëmundjet e parandalueshme duke promovuar qasjen në shërbimet shëndetësore përgrupet më të prekshme të popullsisë, në partneritet me institucionet relevante shëndetësore vendase dhe organizatat ndërkombëtare si OSH, UNFPA, UNICEF, UNDP, UNAIDS dhe partnerë të tjerë kryesorë.

Aktivitetet e Shoqatës Nacionale do të synojnë të sigurojnë efektivitetin dhe qëndruesh-mërinë duke zbatuar aktivitete ndihmëse jetike përgrupet më të rrezikuara të popullsisë. Si asistent i shtetit dhe institucioneve të shëndetit publik, Kryqi i Kuq do të përpinqet të kontribuojë në realizimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të KB-së me synimin për një të

ardhme më të mirë për të gjithë.

Gjatë vitit 2020, ekipi shëndetësor do të sigurojë mbështetje për organizatat komunale për të përmirësuar aftësinë e komuniteteve për organizimin dhe gatishmërinë e tyre më të mirë për t'iu përgjigjur gjendjeve urgjente të shëndetit publik, të jenë të rezistueshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe të jenë në gjendje të përballen me sfidat dhe kërcënimet e shëndetit publik. Shkëmbimi i praktikave dhe përvojave të mira midis vetë OKKK-ve dhe me shoqatat tjera nacionale, pastaj mbledhja dhe përpunimi i të dhënavë të rëndësishme për programet e parandalimit shëndetësor, analiza, monitorimi dhe vlerësimi i tyre do të jenë baza për planifikimin dhe implementimin më të mirë të aktiviteteve sipas nevojës dhe specifikave në nivelin lokal.

Avokatia dhe lobimi për të kontribuar në arritjen e konceptit të mbulimit shëndetësor universal të promovuar nga Organizata Botërore e Shëndetit do të jenë veglat e synuara për avancimin e sektorit të përgjithshëm shëndetësor në nivelin organizativ. Fusha parësore e punës në fushën e shërbimeve shëndetësore do të jetë krijimi i dy shërbimeve të reja, njëri prej të cilëve tashmë është në fazën pilot "Udhëzues në Qendrat Klinike në Shkup" zbatuar nga Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit, i cili synon të ndihmojë pacientët të cilët kanë nevojë për ndihmë të përshtatshme kur iu referohen klinikave për kontroll. Në vitin 2020 ky model është planifikuar të zgjerohet dhe zbatohet në spitalet klinike në Tetovë, Shtip dhe Manastir. Shërbimi i dytë ka të bëjë me transportin e personave të sëmurë, personave të operuar dhe të pafuqishëm, që kanë nevojë për transport të veçantë mjekësor. Do të përgatitet një elaborat për funksionimin e këtij shërbimi dhe do të analizohen mundësitat për financimin e tij. Shërbimi i dytë do të ofrojë mbrojtje për pacientët që kanë nevojë për transport të veçantë/të përshtatshëm mjekësor pas operacionit. Për funksionimin e këtij shërbimi do të përgatitet një elaborat – programor dhe finansiar dhe do të analizohet perspektivat ligjore për themelimin dhe funksionimin e tij të mëtejshëm.

**Qëllimi kryesor: Avancimi i kapaciteteve shëndetësore-parandaluese të Shoqatës Nacionale për reagim në kohë dhe adikuat ndaj sfidave shëndetësore.**

### Aktivitetet:

- Krijimi i një sistemi efikas të vlerësimit të shëndetit në situata emergjente, kujdesi shëndetësor bazë, kontrolli shëndetësor publik dhe epidemiologjik, mbështetja psikosociale dhe ndihma e parë për të siguruar një reagim efikas në zvogëlimin e efekteve vdekjeprurëse dhe negative në shëndetin e

njeriut në situata emergjente dhe krizave. Kjo do të realizohet përmes trajnimeve dhe organizimit të ushtrimeve simuluese.

- Kontributi në eliminimin e tuberkulozit dhe HIV/SIDA, me një fokus të veçantë në luftimin e stigmës dhe diskriminimit, qasjen në shërbime, aktivitete në terren dhe qasje efikase për të arritur dhe përfshirë popullsitetë kryesore, avokimin dhe lobimin.
- Ulja e efekteve të dëmshme në shëndetin e popullsisë si rezultat i ndryshimit të klimës, si pjesë e bartësve të aktiviteteve në Planin Nacional të Veprimit për Valët e Nxehta dhe të Ftohta dhe anëtarësimit të KKRMV-së në komisione dhe organe të ndryshme të ndryshimeve klimatike.
- Promovimi i mënyrës së jetesës dhe zakoneve të shëndetshme. Duke pasur parasysh që në një masë të konsiderueshme shëndeti varret nga dinamika e përcaktuesve fizikë, biheviorale dhe socialë, nismat që rrjedhin nga komuniteti që janë një mundësi për të përmirësuar shëndetin duke investuar në popullsinë dhe shëndetin publik.
- Duke përdorur metodologjinë e shëndetit bazuar në komunitet dhe ndihmës së parë, ne do të kontribuojmë në ndërtimin e komuniteteve që janë të forta dhe të përgatitura për të menaxhuar më mirë rreziqet shëndetësore. Aktivitetet shëndetësore do të përfshijnë një qasje dhe mbështetje gjithëpërfshirëse që do të përfshijë përbërës të ndryshëm shëndetësor si parandalimin e epidemisë dhe përhapjen e sëmundjeve infektive, ndihmën e parë, shëndetin mendor/mbështetjen psikologjike (përfshirë ndihmën e parë psikologjike), promovimin e mënyrës së jetesës së shëndetshme, promovimin e higjienës.

### Rezultatet e pritura:

- Sigurimi i mbështetjes dhe uljes së stigmës, diskriminimit dhe marginalizimit për grupet e cenesëshme të synuara;
- Bashkëpunimi në nivel nacional me institucionet dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare është forcuar dhe zgjeruar dhe aftësia e vetëqeverisjeve lokale për të përballuar sfidat shëndetësore është përmirësuar;
- Është ngritur ndërgjegjësimi i publikut për masat parandaluese shëndetësore dhe edukimi midis grupeve të ndryshme të synuara dhe individëve në komunitete dhe kapaciteti i OKKK-ve për menaxhimin e rreziqeve shëndetësore është rritur.



## NDIHMA E PARË

Dhënia e një edukimi cilësor të ndihmës së parë është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kryqin e Kuq dhe së këtejmi aktivitetet e dhënies së ndihmës së parë bazohen në standartet ndërkombëtare të ndihmës së parë dhe rekomandimet dhe praktikat e fundit. Një përparësi e veçantë do t'i jepet krijimit dhe funksionimit të një Qendre Profesionale të Ndihmës së Parë. Krijimi i kësaj qendre do të ketë për detyrë të ngrejë nivelin e cilësisë së ofrimit të trajnimit të ndihmës së parë dhe aftësimin e kandidatëve cilësorë që do të dinë se si të ofrojnë siç duhet ndihmën e parë.

Si asistent i institucioneve të shëndetit publik, Organizata do të përpinqet të ruajë cilësinë e edukimit për dhëni e ndihmës së parë duke siguruar burime njerëzore me cilësi të lartë të edukuar për të dhënë ndihmën e parë të përgatitur për të reaguar dhe siguruar ndihmë në një sërë situatash dhe aktivitetesh. Kurset e rifreskimit të ndihmës së parë për shoferët do të organizohen gjithashtu në nivel nacional.

Në mënyrë që të mbetemi lider në edukimin e ndihmës së parë, Kryqi i Kuq do të vazhdojë të monitorojë dhe përmirësojë programet e tij të bazuara në standarde dhe praktika të dëshmuara në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Globale të Referimit të Ndihmës së Parë dhe Rrjetin Evropian të Edukimit për Ndihmën e Parë.

**Qëllimi kryesor:** Sigurimi i një edukimi cilësor dhe të bazuar në shkencë të ndihmës së parë i arritshëm për të gjithë ata që do të kontribuojnë në ndërtimin e komuniteteve të sigurta dhe të shëndetshme duke parandaluar dhe zvogëluar rreziqet në aksidente dhe katastrofa të përditshme.

### Aktivitetet:

- Organizimi i kurseve të ndihmës së parë për aftësimin e kandidatëve për shoferë të automjeteve.
- Organizimi i kurseve të ndihmës së parë për aftësimin e personave juridikë.
- Kryerja e edukimit të ndihmës së parë për grupet e synuara të institacioneve arsimore.
- Organizimi i kurseve për edukatorët dhe demonstruesit e sapo-licencuar të ndihmës së parë;
- Organizimi i trajnimeve për grimerë për prezentimin real të plagëve dhe lëndimeve;
- Organizimi dhe zbatimi i kurseve të rifreskimit të ndihmës së parë për shoferët në nivel nacional
- Përfshirja në edukimin e ndihmës së parë të vullnetarëve të Kryqit të Kuq përmes pjesëmarjes në kurse themelore dhe të përparuara të



shpëtimit të jetës, të organizuara nga Qendra Mjekësore Ushtarake e Ministrisë së Mbrojtjes;

- Rioranizimi i Garës Shtetërore të Ndihmës së Parë;
- Shënimi i Ditës Botërore të Ndihmës së Parë;
- Shënimi i Ditës Botërore të Kujtimit të Viktimave të Trafikut Rrugor;
- Zbatimi i një fushate për të promovuar ndihmën e parë duke transmetuar spote televizive me temë ndihmën e parë;
- Publikimi i materialit informativ dhe edukativ për ndihmën e parë dhe hartimi i një doracaku të ri të ndihmës së parë për kandidatët për shofer;
- Transferimi dhe shkëmbimi i përvojave të ndihmës së parë me shoqatat e tjera nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe;
- Aktivizimi i Trupit Koordinues për Ndihmën e Parë që përfshin përfaqësues të institucioneve dhe organizatave kompetente të përfshira në këtë fushë;
- Krijimi i një Qendre Profesionale të Ndihmës së Parë - përgatitja e programeve dhe akteve për funksionimin e kësaj qendre në përputhje me standartet për fushat specifike.

### Rezultatet e pritura:

- Kapacitete të përmirësuara njerëzore dhe materiale të Shoqatës Nacionale për të ofruar përbajtje të ndryshme dhe cilësore të programit në fushën e ndihmës së parë;
- Promovimi i rëndësisë së ndihmës së parë për kandidatët për shoferë të automjeteve në rritjen e sigurisë së trafikut rrugor;
- Janë zhvilluar aktivitete të reja të programit dhe projektit për edukimin dhe promovimin e ndihmës së parë.
- Zhvillimi i partneritetave strategjike me organizatat dhe institucionet kryesore të përfshira në procesin e vendimmarrjes, si dhe sigurimi i mbështetjes për OKKK-të për të forcuar dialogun me autoritetet lokale dhe institucionet dhe organizatat kryesore për të krijuar kushte themelore të qasjes dhe ndihmës për grupet më të rrezikuara të popullsisë bazuar në parimet themelore dhe vlerat e KKRMV-së.
- Kontributi në uljen e vdekshmërisë dhe parandalimin e paraqitjes së sëmundjeve të parandalueshme dhe infektive duke promovuar stilet dhe zakonet e shëndetshme të jetës duke përdorur qasjen e mësimit gjatë gjithë jetës.



## DHURIMI I GJAKUT

Dhurimi i gjakut zhvillon cilësitë e humanizmit dhe solidaritetit dhe ka një rëndësi edukative për qytetarët, dhe veçanërisht për të rinjtë, kontribuon në ngritjen e nivelit të kulturës shëndetësore dhe ndërgjegjësimt të publikut. Motivimi i popullsisë për dhurim vullnetar të gjakut është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ndërtimin e një qëndrimi pozitiv ndaj dhurimit të gjakut.

Gjaku si ilaç është akoma i pazëvendësueshëm dhe marrja e tij varet vetëm nga vullneti i mirë i dhuruesve të gjakut, të cilët vullnetarisht, në mënyrë anonime, falas dhe në mënyrë solidare dhurojnë gjak. Gjaku dhe përbërësit e gjakut që janë marrë nga dhurimi vullnetar i gjakut janë një burim i rëndësishëm nacional për të parandaluar mungesat e gjakut dhe për të përbushur nevojat e shërbimeve të mjekësisë së transfuzionit për të trajtuar patientët në mbarë vendin. Patientët duhet të kenë qasje të barabartë në gjak, bazuar në nevojat e tyre klinike dhe spitalore, dhe siguria e patientëve dhe dhuruesve të gjakut duhet të jetë në nivelin më të lartë. Prioritet do t'i jepet formave dhe metodave të tërheqjes dhe motivimit të popullsisë studentore për dhurim vullnetar të gjakut, për të cilën janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me rektorët e universiteteve publike dhe private.

**Qëllimi kryesor:** Kontributi në promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut për të siguruar sasinë e nevojshme të gjakut dhe përbërësve të gjakut që janë

të domosdoshëm për të trajtuar të sëmurët dhe të lënduarit në vendin tonë.

### Aktivitetet:

- Shënim i 17 Marsit - Dita e dhurimit të gjakut në RMV. Aktivitete promovuese dhe solemne, dhënia e çmimeve dhe mirënjojjeve për OK-KK-të më të suksesshme që kanë përbushur planin e dhurimit të gjakut;
- Shënim i 14 Qershorit - Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut.
- Organizimi i Forumit të Dytë për dhurimin vullnetar të gjakut;
- **Realizimi i Programit për organizimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut në RMV.** Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe të përhershëm me Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit, do të monitorohen dhe koordinohen të gjitha aksionet e dhurimit të gjakut të parashikuara në Planin Vjetor të Integruar për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke dhënë këshilla dhe rekomandime të ekspertëve për OKKK-të dhe SHMT-në, duke përgatitur materiale shëndetësore-edukative dhe propaganduese dhe duke bërë mirënjojje jubilare për dhuruesit e gjakut, duke kryer sondazhe, duke organizuar ligjërata dhe

tribuna dhe duke zhvilluar fushata me grupe të ndryshme të synuara, duke organizuar seminare dhe punëtori edukative për edukimin e motivuesve për dhurimin vullnetar të gjakut, duke zbatuar aktivitete në përputhje me Strategjinë e Dhurimit të Gjakut dhe Politikën e Dhurimit të Gjakut të vitit 2013, duke informuar popullsinë për domethënien e dhurimit të gjakut përmes mediave elektronike dhe të shkruara, rrjeteve sociale, e-gazetës dhe faqes së internetit të Kryqit të Kuq të RMV-së, duke mbajtur shënimë elektronike dhe të shkruara për dhuruesit e gjakut dhe duke përgatitur raporte mujore, periodike dhe vjetore;

- **Përgatitja e Strategjisë së dhurimit vullnetar të gjakut për periudhën 2020-2025.** Organizimi i debateve ekspertuese dhe takimeve promovuese në OKKK-të për të promovuar qëllimet strategjike të Kryqit të Kuq të RMV-së për dhurimin vullnetar të gjakut;
- **Organizimi i aksioneve të jashtëzakonshme dhe tradicionale të dhurimit të gjakut gjatë verës.** Për të mos munguar gjaku dhe përbërësit e gjakut gjatë verës, përpjekje shtesë do të ndërmerren në bashkëpunim me OKKK-të dhe SHMT-në për të organizuar një numër të mjaftueshëm aksionesh të jashtëzakonshme dhe tradicionale të dhurimit të gjakut;
- **Organizimi i punëtorive dhe seminareve për edukimin e motivuesve të rinj për dhurimin vullnetar të gjakut.** Këto punëtori dhe seminare do të përfshijnë një numër të madh grupesh të synuara, kryesisht populisia e re, motivues për dhurim vullnetar të gjakut për nevojat e OKKK-ve dhe edukimin për komunitetin etnik shqiptar, në mënyrë që të rritet numri i dhuruesve të gjakut nga kjo popullsi;
- **Aktivitetet e Klubeve të Dhurimit të Gjakut dhe Klubet 25.** Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut i kushton vëmendje

të madhe punës vullnetare të Klubeve të dhurimit të gjakut në mënyrë që të mobilizojë një numër më të madh të dhuruesve të gjakut, të cilët janë informuar rregullisht për të gjitha aktivitetet dhe problemet me të cilat përballen në veprimtarinë e dhurimit të gjakut. Theksi i veçantë do t'i vihet veprimtarive që lidhen me përfitimet e dhuruesve të gjakut që kanë dhuruar gjak më shumë se 10 herë dhe janë të liruar nga pagesa e participimit kur përdorin disa lloje të shërbimeve shëndetësore. Aktivitetet e Klubit 25 të dhuruesve të rinj dhe potencialë të gjakut janë të popullarizuara për të rritur numrin e tyre, për të rekrutuar dhe mbajtur ata siç duhet në procesin e dhurimit të gjakut dhe për të kriuar një rrjet të dhuruesve të rinj të gjakut për të promovuar dhe motivuar dhuruesit e rinj të gjakut në institucionet arsimore (në shkollat e mesme dhe fakultetet).

- **Aktivitetet e Qendrës ditore të dhurimit të gjakut.** Një hap më tej në procesin e promovimit të dhurimit të gjakut në territorin e Shkupit është funksionimi i Qendrës ditore të dhurimit të gjakut. Në një dhomë të përshtatur dhe të pajisur me qëllim brenda SHOH "Dare Xhambaz", në një mjedis të bukur dhe të ngrohtë, dhuruesit e gjakut kanë mundësinë të tregojnë humanizmin e tyre përmes aktit të dhurimit të gjakut çdo ditë pune dhe çdo të shtunë.
- **Bashkëpunimi i Kryqit të Kuq me SHN të tjera, organizata joqeveritare dhe partnere nga brenda dhe jashtë vendit.** Për të shkëmbir përvoja në fushën e dhurimit të gjakut ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me shoqatat tjera nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe me organizatat tjera joqeveritare dhe partnere që punojnë dhe arrijnë rezultate të mira në dhurimin e gjakut.

## Rezultatet e pritura:

- Rritja e numrit të dhuruesve të rinj të gjakut dhe rritja e vetëdijesimit tek të rinjtë për dhurimin vullnetar të gjakut;
- Grupet e synuara parësore janë identifikuar, mobilizuar dhe përfshirë në procesin e dhurimit të gjakut;
- Rritja e numrit të motivuesve vullnetarë të apo trajnuar për dhurim vullnetar të gjakut dhe përfshirja me sukses në mjediset e tyre;
- Rritja e numrit të edukatorëve të bashkëmoshatarëve të rinj për dhurimin e gjakut të cilët përmes aktiviteteve të Klubeve 25 promovojnë me sukses dhurimin vullnetar të gjakut midis të rinjve në shkollat e mesme dhe në fakultete;



## RINIA E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Duke ndjekur tendencat globale, siç është zhvillimi i teknologjisë, rritja e lëvizshmërisë dhe veprimi shumë-burimor i të rinjve në shoqëri, është e justifikuar të pritet që përfaqësimi i rritur i të rinjve në organizatë mund të sjellë freski, risi dhe inovacion në punën e Shoqatës Nacionale për të plotësuar nevojat e grupeve të ceneshe të popullsisë. Metodat e shpejta të komunikimit dhe rrjetet sociale që janë tashmë pjesë e rutinës së përditshme të të rinjve e bëjnë më të lehtë dhe më të gjerë promovimin e mesazheve dhe thirrjeve humanitare për vullnetarizëm ose mbështetje. Përmes shfrytëzimit të mundësive të ofruara nga interneti dhe komunikimi elektronik do të përpinqemi të azhurnojmë format ekzistuese të veprimit të të rinjve, veçanërisht duke forcuar kapacitetet e tyre përmes krijimit të platformave mësimore, regjistrimit dhe arkivimit të aktiviteteve dhe angazhimeve vullnetare përmes aplikacioneve softuerike, si dhe vendosjes së një sistemi më efektiv për koordinimin e punës së përgjithshme të të rinjve në Shoqatën Nacionale.

**Qëllimi kryesor:** Struktura e forcuar e të rinjve në Organizatë për përbushje efikase të aktiviteteve të Shoqatës Nacionale.

### Aktivitetet:

**Klubet shkollore të Kryqit të Kuq.** Pas zbatimit të suksesshëm të fazës pilot në vitin 2019 ku u hapën me sukses 67 klube shkollorë, gjatë këtij viti do të iniciohet hapja e edhe 20 klubeve shkollore brenda

shkollave fillore dhe të mesme. Përmes kësaj forme të organizimit të punës vullnetare, përvèç rritjes së numrit të të rinjve vullnetarë, aktivitetet e Kryqit të Kuq afrohen më afér komuniteteve, duke rritur ndjeshëm popullsinë në të cilën përhapen vlerat humanitare.

**Zhvillimi i qasjes “nga moshatari tek moshatari” tek të rinjtë.** Transmetimi i informacionit dhe mesazheve ndërgjegjësuese mes bashkëmoshatarëve në lidhje me sfidat e ndryshme që prekin jo vetëm të rinjtë, por edhe të gjithë shoqërinë, është një model i dëshmuar për arsimim të suksesshëm joformal dhe ndërtimin e komuniteteve të rezistueshme. Programet për parandalimin e infeksioneve të transmetueshme seksualisht, trafikimit të qenieve njerëzore dhe sëmundjeve të varësisë janë vetëm disa nga temat që do të janë në plan të parë të aktiviteteve të klubeve rinore. Gjatë vitit do të forcohet bërthama nacionale e trajnerëve të të rinjve që do të janë në disponicion për të përbushur nevojat e Organizatës. Edukatorët e bashkëmoshatarëve do të zhvillojnë mbi 1000 punëtori për edukimin e moshatarëve për të rinjtë për programet parandaluese të Kryqit të Kuq me pjesëmarrjen e mbi 20.000 pjesëmarrësve.

**Forcimi i kapaciteteve të vullnetarëve të rinj.** Zhvendosjet demografike dhe tendenca e emigrimit të popullsisë në pjesën më të madhe të vendit imponon nevojën e përpjekjeve shtesë për të motivuar dhe zhvilluar programe atraktive vullnetare të të rinjve. Format e krijuara tashmë të ngritisës së kapaciteteve rinore siç janë kampet verore nacionale, akademia rinore dhe format e tjera të trajnimit dhe shkëmbimit të përvjave, do të rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në punën e përgjithshme të Shoqatës Nacionale.

### Rezultatet e pritura:

- Rritja e numrit të vullnetarëve të rinj në Organizatë
- Rritja e numrit të përfituesve të përfshirë në aktivitetet rinore të Shoqatës Nacionale



## DISEMINIMI DHE DNH

Programi i diseminimit është një nga mjetet më të rëndësishme për promovimin e punës së Kryqit të Kuq. Ai është një fillesë themelore për shkëmbimin e informacionit në lidhje me Kryqin e Kuq, historinë dhe kuptimin e Lëvizjes sonë, shtatë parimet tona themelore, emblemat e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, rolin ndihmës të Kryqit të Kuq në vend, promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare, inkurajimin e arsimit humanitar si një qasje e Lëvizjes, mobilizimin e vullnetarëve dhe anëtarëve dhe mbështetësve të rinj të Organizatës, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për kuptimin dhe rolin e Kryqit të Kuq në vend dhe nevojën për mbrojtjen e emblemës dhe personelit të Kryqit të Kuq në kryerjen e mandatit dhe detyrave të tij në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë dhe Ligjin e Kryqit të Kuq të RMV-së.

**Qëllimi kryesor:** Njohuri të diseminuara mbi Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

### Aktivitetet:

**Fushata për mbrojtjen e emblemës.** Fushata për mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq jep një kontribut të veçantë në rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq dhe respektimin e vazhdueshëm nga institucionet, organizatat dhe individët në vend. Fushata do të zbatohet në të gjithë shtetin në bashkëpunim me mediumet për të siguruar efektet e dëshiruara për përcjelljen efektive të mesazheve të Kryqit të Kuq për publikun e gjerë. Qëllimi kryesor i fushatës është të informojë publikun për përdorimin e duhur të emblemës, mbrojtjen nga keqpërdorimi i emblemës dhe promovimin e rolit dhe detyrave të Kryqit të Kuq. Disa nga aktivitetet e parashikuara në fushatë janë shpërndarja e materialit promovues, ligjëratat në institucionet edukative arsimore, publikimi i edicionit të rishikuar të rregullave të përdorimit të emblemës, anketimi i qytetarëve për njohuritë e emblemës, takimet me përfaqësuesit e ministrive kompetente, institucionet e arsimit të lartë, institucionet shëndetësore dhe organizatat ndërgjegjësuese për të shmangur keqpërdorimin dhe keq-

interpretimin e përdorimit të emblemës, sesionet e diseminimit të diseminuesve në mjediset lokale dhe pjesëmarrja në emisionet e radios dhe TV-së. Theks i veçantë i është kushtuar aktiviteteve të caktuara në shënimin e 8 Majit - Ditës Botërore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, si dhe në kornizat e Javës së Kryqit të Kuq të RMV-së më 8-15 maj.

**Klubi i Diseminuesve të Së Drejtës Ndërkom-bëtare Humanitare.** Respektimi i Së Drejtës Ndërkom-bëtare Humanitare (DNH) është një nga angazhimet thelbësore të Lëvizjes Ndërkom-bëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe i cili bazohet në dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë. Kryqi i Kuq punon me përkushtim në promovimin e DNH-së në vend. Në vitin 2019 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut themeloi Klubin e Diseminuesve të DNH-së, i cili synon të sigurojë mbështetje thelbësore në promovimin e DNH-së duke organizuar dhe promovuar aktivitete të Shoqatës Nacionale në fushën e Së Drejtës Ndërkom-bëtare Humanitare me grupe të ndryshme të synuara në vend, në veçanti para rinisë studentore, ARMV-së dhe MPB-së dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse që kanë një rol të caktuar në promovimin dhe diseminimin e DNH-së në RMV, kryesisht Parlamentit të RMV-së dhe ministri i qeveritare. Klubi, në përbërjen e të cilit janë diseminues të spikatur dhe ekspertë universitarë të DNH-së, përmes programit vjetor parashikon botimin e një manuali dhe udhëzuesi të diseminuesve të DNH-së, organizimin e një konference ndërkom-bëtare të DNH-së, tribuna - DNH për deputetët, një garë të DNH-së midis Universiteteve të RMV-së, një shkollë verore për DNH-në me një program specifik, trajnimin e studentëve për DNH-në, shkëmbimin e përvojave me ekspertë dhe shoqata nacionale të tjera, krijimin e një platforme teknike për komunikim më të mirë dhe më të suksesshëm dhe shkëmbim dokumentesh.

**Komiteti Nacional për Të Drejtën Ndërkom-bëtare Humanitare.** Komiteti është i vendosur në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është themeluar si një trup operativ koordinues nacional në RMV, në përputhje me instrumentet ndërkom-bëtare në fushën e DNH-së, si një segment i të drejtës ndërkom-bëtare, në të cilin Republika e Maqedonisë Veriore është anëtare, për të siguruar zbatimin e tyre efikas në nivelin nacional. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, trupi kryesohet nga një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë. Komiteti Nacional i DNH-së punon për çështje dhe jep rekomandime në lidhje me: harmonizimin e legjislacionit nacional me Të Drejtën Ndërkom-bëtar Humanitare; implementimin efektiv të DNH-së duke ndërmarrë dhe monitoruar masa dhe aktivitete praktike; moni-

torimin e zhvillimit të DNH-së dhe diseminimin e saj në segmente të ndryshme të jetës shoqërore; avancimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve kompetente, përfshirë dhe bashkëpunimin me Kryqin e Kuq, me qëllim të identifikimit të aktiviteteve që rrjedhin nga fusha e DNH-së dhe dispozitat ligjore. Në vitin 2020 do të ketë 5 takime pune.

**Trajnimet për diseminimin.** Përmes aktiviteteve të tij të diseminimit, Kryqi i Kuq ka trajnuar diseminues në të gjitha organizatat komunale të Kryqit të Kuq që edukojnë dhe shpërndajnë njohuritë në grupe të ndryshme të synuara gjatë gjithë vitit. Këta janë kryesisht të rindërtuar në shkolla filllore, të mesme dhe fakultete, siç kryhen dhe ligjérata diseminuese dhe shpërndahet materiali diseminues për punën dhe detyrat e Kryqit të Kuq në institucionet dhe grupet të synuara të ndryshme në të gjithë vendin. Shoqata Nacionale çdo vit kryen trajnime të reja të rregullta për aftësimin e 35 diseminues të rindërtuar për zhvilluar trajnime diseminimi në nivelin lokal, gjë që jep një kontribut të veçantë për të gjallëruar interesin e publikut të gjërë për marrë pjesë në aktivitetet e Shoqatës Nacionale.

**Sesionet e diseminimit me universitetet.** Një nga grupet kryesore të synuara në lidhje me diseminimin janë trajnimet dhe aktivitetet e të rindve në universitetet e RMV-së. Kjo do të bëhet duke zhvilluar 15 ligjérata diseminuese, si dhe ligjérata dhe trajnime profesionale për Të Drejtën Ndërkom-bëtare Humanitare, shkolla verore dhe gara, me qëllim të përmirësimit të njohurive të të rindve dhe në të njëjtën kohë të mobilizohen vullnetarë të rindërtuar në Organizatë.

**Sesione diseminimi me Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.** Shoqata Nacionale vazhdon të kryejë 10 trajnime diseminimi për oficerët e ARMV-së. Qëllimi kryesor është sigurimi i aftësimit profesional me theks në respektimin e dispozitave të Së Drejtës Ndërkom-bëtare Humanitare dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, si dhe shkëmbimin e përvojave dhe informacionit në lidhje me punën e Shoqatës Nacionale brenda sistemit të menaxhimit të krizave të vendit. Aktivitetet zbatohen çdo vit në përpjekje me një program vjetor të përgatitur të bashkëpunimit midis dy institucioneve.

**Sesione diseminimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.** Kryqi i Kuq do të zhvillojë 5 trajnime diseminimi për pjesëtarët e MPB-së përmes ligjératave të specializuara, ku do të njihen me dispozitat e Së Drejtës Ndërkom-bëtare Humanitare, mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq dhe rolin dhe detyrat e Kryqit të Kuq.

**Projekt pilot i PVH-së për fëmijët në SHF-të nga 6 deri në 12 vjeç** - Më shumë se 20 vjet, për grupin e synuar të të rindve të moshës nga 13 deri në 17 vjeç, në mbarë vendin tonë, me sistemin e tij tematik, struk-

turor dhe metodologjik, funksionon Programi KKA-PVH (Kryqi i Kuq në Aksion – Promovimi i Vlerave Humane), si një vegël e vërtetuar për përhapjen e njohurive dhe praktikimin e misionit dhe vizionit humanitar duke promovuar vlerat humane, kulturën si sistem vlerash, kulturën e dialogut, jo-dhunën dhe paqen, duke bërë ndryshime të dukshme pozitive në personalitetin e të rinjve me dallime të ndryshme gjinore, etnike, kombëtare, fetare dhe të tjera dallime. Periodikisht, Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës si mbështetje institucionale janë të përfshirë në strukturën organizative dhe programore.

Duke pasur parasysh kapacitetin, mundësitetë dhe vlerësimet, ekziston nevoja për mbulim programor të fëmijëve dhe nxënësve të moshës nga 6 deri në 12 vjeç në një sistem të shpërndarjes së njohurive humanitare, së të drejtave dhe parimeve dhe promovimit të vlerave humanitare së bashku me përfshirjen e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ideja e projektit do të përshtatet me metodologjinë e ndërtuar me qasje interaktive dhe formatin e transferimit të njohurive dhe kontrollit të kontekstualizmit, informacionit dhe funksionalizimit të dozuar përmes diseminuesve dhe instruktorëve të trajnuar dhe në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe me theksin tematik në: njohjen dhe respektimin e diversitetit, kulturën si sistem vlerash, kulturën e dialogut, jo-dhunën dhe paqen.

Aktivitetet e projektit do të zbatohen përmes formatit të punëtorive të rregullta edukative, kryesisht duke përfshirë dhe trajnuar 30 deri 40 fëmijë/ nxënës për një shkollë, të cilët pastaj në bazë të parimit të vullnetarizmit, si dhe monitorimit të aktiviteteve dhe përfshirjes së tyre, do të sugjerohen për përfshirje në sistemin dhe procedurat e Programit KKA-PVH dhe përfshirje aktive si vullnetarë në Klubet Rinore të Kryqit të Kuq.



### **Rezultatet e pritura:**

- Diseminues të edukuar për grupe të synuara specifike
- Diseminues të edukuar të DNH-së për grupe të synuara specifike
- Është rritur numri i personave të edukuar për DNH-në sipas grupeve të synuara të përcaktuara para-prakish



## KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA-PVH)

„Kryqi i Kuq në Aksion - Promovimi i Vlerave Humane“ (KKA-PVH) për më shumë se 20 vjet ka qenë një vegël nacionale për rekrutimin dhe mbajtjen e vullnetarëve në Kryqin e Kuq. Në ciklin KKA-PVH për vitin 2020, si dhe në dy vitet e fundit, OKKK-ve do t'u ofrohet opsioni për të aplikuar dhe kotizuar për pjesëmarrje në program. Theksi i programit do të jetë në rritjen e numrit të vullnetarëve të moshës deri në 17 vjet në të gjitha OKKK-të, promovimin e Organizatës, përmirësimin e imazhit të Organizatës, zbutjen e vuajtjeve të popullsisë të ceneshe, promovimin e njohurive aktive dhe qasjes aktive të këtyre të rinjve në jetë, përmes vlerave dhe parimeve të Kryqit të Kuq..

**Qëllimi kryesor: Promovimi i kulturës së dialogut si parakusht themelor për ndërtimin e një shoqërie ndërkulturore.**

### Aktivitetet

Gjatë ciklit, do të organizohen dy punëtori përgatitore për instruktorët e PVH-së, 100 trajnime nga instruktorët dhe diseminuesit që do të trajnojnë të rinjtë për ciklin tjetër, si dhe një punëtori përfundimtare dy-ditore për 80 pjesëmarrës, në të cilat të rinjtë më të mirë do të fitojnë njohuri të thelluara për Kryqin e Kuq, punën ekipore, shkathësitë drejtuese dhe kulturën si një sistem vlerash. Gjatë ciklit të këtij viti, do të realizohet një piknik i përbashkët dhe një shikim i përbashkët i një filmi, aktivitete që do të motivojnë më tej të rinjtë. Në fund të ciklit, do të realizohet edhe Trofeu PVH, mirënjoyje për të rinjtë që kanë bërë projektet më të mira. Në muajin shtator do të shënohet gjithash-

tu Java KKA-PVH nga 21 deri në 27 shtator përmes së cilës të rinjtë promovojnë tolerancën, paqen dhe bashkëjetesën në vendin tonë.

Programi ka 30 instruktorë nacionalë të trajnuar KKA-PVH, të cilët formojnë Kolegin KKA-PVH. Çdo vit trajnohen 40 diseminues të mentoruar direkt nga instruktorët për të zbatuar më lehtë dhe më mirë programin në secilën Organizatë Komunale të Kryqit të Kuq. Sistemi i mentorimit nga instruktorët drejt diseminuesve komunalë do të ndikojë në lidhjen e diseminimit dhe aktiviteteve humanitare në terren, qasjen më cilësore në përpunimin e projekteve të vogla dhe promovimin më të madh të Organizatës sonë.

Me implementimin e Programit, pritet që 1.100 të rinj të përpunojnë midis 120 dhe 150 projekte të vogla për të mirën e komunitetit në të cilin jetojnë, duke ndihmuar direkt rreth 2.500 deri në 3.000 individë të grupeve të ndryshme të ceneshe në RMV përmes investimit të 35.000 orëve vullnetare. Për një përqindje të madhe të këtyre personave përmes implementimit të projekteve ndryshojnë kushtet e tyre të përditshme të jetesës dhe ato përmirësohen. Por gjithashtu një numër i madh i projekteve konsistonë në donacione ose mbështetje për spitalet, qendrat e kujdesit ditor për personat me aftësi të kufizuara fizike, shkollat, kopshtet e fëmijëve, objektet kulturore ose vendet publike dhe janë mbështetje e drejtpërdrejtë për komunitetet nga vijnë të rinjtë. Kjo rrit numrin e njerëzve që ndiejnë përfitimin e drejtpërdrejtë të projekteve të vogla shumëfish. Është veçanërisht e rëndësishme që programi ua ndryshon të rinjve rutinën e tyre të përditshme, e bën atë më cilësore dhe përmes tij përvetësojnë shkathtësi të rëndësishme jetësore.

### Rezultatet e pritura:

- Krijimi dhe implementimi i nismave të projekteve për të përmirësuar mirëqenien e popullsisë së prekshme në nivelin lokal.
- Numri i rritur të vullnetarëve të rinj në Organizatë të aftesuar për të kontribuar në përballimin e sfidave të ndryshme në nivel lokal.



## RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe që në fazat e hershme të themelimit të saj kryen aktivitete që lidhen me rivendosjen e lidhjeve familjare, d.m.th. kërkimin e personave të zhdukur si rezultat i luftës, migracionit ose krizës dhe ribashkimi i tyre me familjet. Ky shërbim unik është thelbi i punës së Lëvizjes dhe rregullohet me Ligjin e Kryqit të Kuq, në përputhje me rolin ndihmës të Kryqit të Kuq në shtet. Ky shërbim realizohet në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq i cili mbështet një pjesë të aktiviteteve të Shoqatës Nacionale. Trajnimi profesional organizohet çdo vit për të aftesar dhe përmirësuar kapacitetin e personave që punojnë në nivel nacional dhe lokal për të siguruar punë profesionale në rivendosjen e marrëdhënieve familjare për personat dhe familjet e interesuar në të gjithë botën.

**Qëllimi kryesor:** Sigurimi i përgjigjes në kohë ndaj nevojave humanitare të popullsisë për rivendosjen e lidhjeve familjare.

### Aktivitetet:

- Vazhdimi i aktiviteteve të Shërbimit për rivendosjen e lidhjeve familjare të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që synon një zgjidhjen e rasteve të rivendosjes së lidhjeve familjare në lidhje me krizen e migruesve që është aktuale vitet e fundit. Për këtë qëllim,

është e nevojshme të mundësohet vazhdimi i mbështetjes logjistike të ekipeve të Shërbimit të Kërkimit.

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe ndjekja e rekomandimeve të tyre për funksionimin e Shërbimit, të harmonizuara në nivelin e Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Përgatitja e raporteve dhe statistikave mujore dhe dërgimi i tyre me kohë në Qendrën Informative Rajonale për rivendosjen e lidhjeve familjare në Beograd;
- Përmirësimi i kapaciteteve të ekipoit të rivendosjes së lidhjeve familjare brenda Njësisë së Reagimit të Kryqit të Kuq të Maqedonisë së Veriut dhe organizimi i trajnimeve rifreskuese për të brenda kornizës së Planit të trajnimit të Shoqatës Nacionale për reagimin në katastrofa;
- Pjesëmarrja në takimet ndërkombëtare të Shërbimeve të Kërkimit për të monitoruar dhe avancuar programet e rivendosjes së lidhjeve familjare brenda shoqatave nacionale;
- Ndërtimi i një marrëdhënie adekuate me Qeverinë dhe institucionet qeveritare dhe organizatat partnere në terren, për të realizuar më me sukses aktivitetet e Shërbimit të Kërkimit.

### Rezultatet e pritura:

- Kapacitetet ekzistuese të Shërbimit janë plotësuar, për realizimin e aktiviteteve të planifikuara të programit dhe zhvillimin e mëtutjeshëm në një Shërbim të përgatitur mirë dhe efikas për rivendosjen e lidhjeve familjare.
- Funksionimi i Shërbimit për rivendosjen e lidhjeve familjare është harmonizuar me rregullat e përcaktuara nga rrjeti ndërkombëtar i rivendosjes së lidhjeve familjare.
- Marrëdhënie pozitive janë krijuar me institucionet qeveritare për të zgjidhur rastet konkrete të zhdukurve



## MODELET MODERNE TË KOMUNIKIMIT TË DYANSHËM

Marrëdhëniet me publikun të Shoqatës Nationale synojnë të avancojnë marrëdhëniet midis Organizatës dhe publikut duke promovuar përparrësitë dhe qëllimet e Kryqit të Kuq që synojnë avancimin e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Marrëdhëniet me publikun janë një funksion i menaxhimit promovues që përdor komunikim të dyanshëm për të lidhur nevojat dhe interesat e një organizate ose një personi me interesat e audiencave të ndryshme me të cilat komunikon Organizata. Marrëdhëniet me publikun janë përqendruar gjithashtu në burimet e brendshme njerëzore të Organizatës në mënyrë që të zhvillojnë dhe forcojnë kulturën organizative, kontrollojnë vlerat që ekzistojnë në Organizatë dhe përmirësojnë llogaridhëni dhe transparencën. Informimi dhe komunikimi i Kryqit të Kuq me publikun është drejtimi dhe prezantimi i duhur i informacionit mbi aktivitetet e Organizatës. Informimi është një mjet zhvillimi i Shoqatës Nationale për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara, ndërsa njëkohësisht siguron llogaridhënie dhe transparencë të punës. Lidhshmëria e informacionit gjithashtu do të sigurojë informacion në kohë të duhur për organizatat partnere, publikun e gjerë dhe përdoruesit e shërbimeve që i marrin nga Shoqata Nationale.

**Qëllimi kryesor:** Teknologjitet e integruar të informacionit dhe komunikimit në punën e Organizatës si element kryesor për ndërtimin thelbësor të kapaciteteve, rrjedhjen e shpejtë të informacionit, rritjen e transparencës dhe llogaridhëni, dhe imazhin e përmirësuar të të gjitha pjesëve integrale të Shoqatës Nationale.

### Aktivitetet:

**Media sociale e Shoqatës Nationale** azhurnohet vazhdimesht dhe ofron hapësirë për publikimin e një larmie informacioni, struktura e të cilave synon katgori të ndryshme të vizitorëve. Për të komunikuar më me sukses me audiencën në internet, Kryqi i Kuq ndërmerr një qasje integruese dhe bashkëpunuese për praktikimin e rrjeteve sociale. Gjithashtu në vitin 2020 do të prezantohet një aplikacion celulari për të promovuar aktivitetet e SHN-së.

**Edicionet javore të gazetës elektronike të Kryqit të Kuq INFO** janë një shembull i një mjeti të suksesshëm për të informuar vullnetarët, partnerët, bashkëpunëtorët dhe mbështetësit tanë për aktivitetet që ne i kryejmë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. E-gazeta botohet një herë në javë dhe shpërndahet në 85.000 adresa të postës elektronike (e-mail).

**Konferencat për shtyp dhe brifingjet përgazetarët e mediumeve** synojnë ta afrojnë Organizatën me mediumet dhe të sigurojnë njoftime në kohë të duhur përmes përgazetarëve të cilat prezantohen ngjarje të rëndësishme humanitare, vizita të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, aktivitete humanitare në lidhje me donacionet, dhe të ngjashme. Në vitin 2020 janë planifikuar 5 konferenca përshtyp dhe brifingje përmes mediat.

**Veprimtaria botuese** - Kryqi i Kuq boton rregullisht publikime tre-gjuhësh të programeve vjetore dhe raporteve me tregues finansiarë të punës së Shoqatës Nacionale që kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e llogaridhënieve dhe transparencës së Organizatës dhe përmirësimin e imazhit të saj para organizatave partnerë dhe publikut në mënyrë që të jetë në gjendje të shpërndajë informacion në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e saj përmes klientëve mundshëm dhe publikun. Shoqata Nacionale në kuadër të shënimit të aktiviteteve kalendarike përgatit rregullisht dhe shtyp broshura, flaerë dhe pllakate përmes publikimit të aktivitetet e Organizatës. Me materialin e shtypur të informacionit shënohet aktivitetet tradicionale dhe aktivitetet tjera të Organizatës. Në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë, 5 pulla postare lëshohen me përmbytje që lidhen me pesë javët tradicionale të Kryqit të Kuq.

**Trajnimi përgazetarët** - Kryqi i Kuq vazhdon të organizojë trajnime përgazetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim të diseminimit të aktiviteteve të Kryqit të Kuq përmes mediumet dhe sigurimin e mbështetjes së mediave përmes aktivitetet e Kryqit të Kuq. Këtë vit do të përfshihen 15 gazetarë nga media të ndryshme elektronike dhe të shkruara.

**Standardet e brendimit të Kryqit të Kuq** transmetojnë besueshmërinë, kompetencën dhe shqetësimin përvisionin, misionin dhe parimet e Organizatës. Përmes këtyre standardave të brendimit të Zyrën Qendrore, Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq. Në procesin e monitorimit do të evidentohet respektimi përkatës dhe do të tregohet zbatimi i duhur i një standardi të përkatës. Në këtë drejtim janë planifikuar 4 punëtorë përmes unifikimit të markëve së Shoqatës Nacionale.

**Hulumtimi i opinionit publik.** Suksesi i punës së Shoqatës Nacionale varet kryesisht nga informimi dhe interesimi i publikut të gjithë në të gjithë vendin, d.m.th. nga opinioni publik. Hulumtimi kontribuon në forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me publikun, matjen e vazhdueshme të nevojave dhe kënaqësisë së publikut dhe forcimin e besimit në ndërtimin e një qëndrimi pozitiv ndaj Kryqit të Kuq.

**Fondi i dukshmërisë së Kryqit të Kuq.** Ndryshtimet në Ligjin për Kryqin e Kuq hapin mundësinë përmes mbështetur promovimin e SHN-së, projekte të iniciuara nga Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq dëshironë qëllim të zhvillojnë dhe promovojnë kapacitetin e tyre përmirësuar performancën dhe rezultatet e punës aktuale.



## Rezultatet e pritura:

- Publiku i informuar përmes aktivitetet e zbatuara të Kryqit të Kuq të RMV-së përmes mjeteve të përfshira moderne të komunikimit.
- Imazhi i forcuar dhe marka e unifikuar e Organizatës.
- Bashkëpunimi i përmirësuar me organizatat partnerë dhe shtëpitë e informacionit dhe mediumeve.



## MENAXHIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdimisht ndjek trendët botërorë në promovimin e punës së Organizatës dhe forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në Shoqatën Nacionale. Në këtë drejtim, angazhimi parësor do të jetë ofrimi i zgjidhjeve novatore për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, përfshirë menaxhimin e performancës së punonjësve në Organizatë. Theksi do të jetë në hapjen e një Qendre Edukative që do të funksionojë përmes një programi të përgatitur paraprakisht për trajnime dhe kurse. Qendra Edukative do të jetë në dispozicion për anëtarët, vullnetarët dhe grupet e synuara të Organizatës dhe do të ofrojë mundësi për të forcuar kapacitetin organizativ dhe promovimin e vlerave kryesore për të cilat angazhohet Organizata.

Aktivitetet aktuale do të përmirësohen me një sistem motivimi dhe përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese, si dhe personelit të ri të mundshëm. Kryqi i Kuq është një brend botëror, një organizatë në të cilën të rinxjtë duan të bëhen anëtarë, vullnetarë dhe të punosohen. Punonjësit do të nxiten dhe inkurajohen vazhdimisht të përdorin një qasje pjesëmarrëse edhe në procesin e planifikimit të aktivitetave të programit të Organizatës për të përfshirë grupet e synuara dhe për të përshtatur aktivitetet ndaj nevojave lokale dhe kontekstit të cilin ata punojnë.

**Qëllimi kryesor:** Vendosja e një sistemi funksional për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të Shoqatës Nacionale duke prezantuar zgjidhje novatore teknologjike dhe duke ndjekur trendët botërorë

## Aktivitetet:

- Vendorsja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi përmes përdorimit të softuerit për punë zyre në Organizatë, i cili do të shërbejë si një mjet për përmirësimin e programeve të Organizatës, analizimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të situatës dhe sigurimin e cilësisë së punës së Shoqatës Nacionale. Të trajnuar të paktën 40 punonjës në Zyrën Qendrore, Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit dhe Organizatat komunale të Kryqit të Kuq për përdorimin e softuerit të monitorimit dhe vlerësimit;
- Krijimi i një programi të edukimit dhe forcimi i kompetencave, kapaciteteve dhe shkathtësive profesionale të anëtarëve, vullnetarëve dhe punonjësve të Organizatës;
- Prezantimi i metodave dhe teknikave të reja për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore në Organizatë;
- Krijimi i një baze të dhënash të personelit të edukuar dhe të kualifikuar sipas veprimtarive;
- Vendorsja e një qasjeje mentoruese në punën e Shoqatës Nacionale në të gjitha nivelet që kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve të së paku 50% të organizatave komunale dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit;
- Përgatitja e udhëzimeve dhe kritereve për përdorimin e sistemit të motivimit të punonjësve dhe vullnetarëve në Organizatë;
- Organizimi i katër trajnimeve për punonjësit në Shoqatën Nacionale për përdorimin e softuerëve për punë në zyrë, veçanërisht për planifikimin dhe monitorimin dhe vlerësimin;
- Përgatitja e analizës tremujore të aktiviteteve të përfunduara sipas veprimtarisë në nivel të Shoqatës Nacionale që përmbajnë të dhëna cilësore dhe sasiore;
- Sigurimi i udhëzimeve për përmirësimin e mënyrës së planifikimit, implementimit dhe raportimit bazuar në rezultatet e analizës tremujore;
- Përpunimi i të paktën tre analizave tremujore dhe publikimi i tyre në faqen e internetit dhe në mediat sociale të Kryqit të Kuq që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për grupet e synuara të Organizatës;
- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe promovimi i vlerave kryesore për të cilat përpinqet Organizata;
- Sigurimi i mbështetjes profesionale në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së vullnetarëve të rinj, të rinjve dhe profesionistëve që janë të përfshirë direkt në aktivitetet e Kryqit të Kuq.



## Rezultatet e pritura

- Krijimi i një sistemi funksional të administrimit të burimeve njerëzore me zgjidhje novatore për ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve dhe vullnetarëve.
- Prezantimi i një qasjeje mentorimi të punës në shumë nivele të Shoqatës Nacionale.
- Zhvillimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi, analizat e të cilët mundësojnë adaptimin e programeve të Organizatës për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme nevojave të grupeve të synuara.
- Kapacitetet e përmirësuara dhe shkathtësítë profesionale të anëtarëve, vullnetarëve dhe punonjësve në Organizatë për të ofruar shërbime cilësore për grupet e synuara.



## PROGRAMI I MBËSHTETJES PSIKOSOCIALE

Në mënyrë që të sigurohet një reagim efikas ndaj katastrofave natyrore, konflikteve dhe sfidave shëndetësore, një nga prioritetet kryesore do të jetë forcimi i kapaciteteve të Organizatës për të ofruar ndihmë dhe mbështetje psikosociale. Për ta arritur këtë, në nivelin e Shoqatës Nacionale, ne po zhvillojmë një program gjithëpërfshirës të mbështetjes psikosociale që do të forcojë kapacitetet e organizatës për të ofruar mbështetje cilësore dhe në kohë për personat që kanë nevojë për këtë.

Mbështetja psikosociale në kontekstin e Kryqit të Kuq sigurohet përmes programeve të krijuara posaçërisht për të përfshirë çështjet psikosociale. Sidoqoftë, më shpesh, mbështetja psikosociale është e integruar në aktivitete dhe programe të tjera, si për shembull në programin shëndetësor gjatë operacionit të sigurimit të ndihmës urgjente, në programet e ndihmës për njerëzit e sëmurë nga HIV/SIDA, ose në programet shkolllore mbështetëse. Në fakt, në shumicën e rasteve, kur proceset natyrore të mbështetjes së anëtarëve të familjes, miqve ose fqinjëve nuk prishen dhe nevojat themelore plotësohen në mënyrë humane, nuk ka nevojë për ndërhyrje më të madhe.

**Qëllimi kryesor:** Krijimi i një programi gjithëpërfshirës për ofrimin e mbështetjes psikosociale për kategoritë e cenesëshme të njerëzve, asistentët e tyre të drejtpërdrejtë, punonjësit dhe vullnetarët në Shoqatën Nacionale.

### Aktivitetet

- Krijimi i një programi me katër nivele për të edukuar dhe forcuar kompetencat, kapacitetet dhe shkathtësitë profesionale të anëtarëve, vullnetarëve dhe punonjësve në Organizatë për të ofruar mbështetje psikosociale në kushte të ndryshme dhe për grupe të ndryshme të synuara.
- Prezantimi i metodave dhe teknikave të reja të punës me kategori të prekshme të personave.
- Përfshirja e mbështetjes psikosociale në aktivitetet e programit të Shoqatës Nacionale.
- Sigurimi i mbështetjes dhe edukimit për të paktën 40 punonjës dhe vullnetarë në organizatat komunale dhe Qytetin e Shkupit për ofrimin e mbështetjes psikosociale përfituesit.

### Rezultatet e pritura

- Zhvillimi i katër niveleve të programit të edukimit dhe sigurimi i mbështetjes psiko-sociale për kategoritë e cenesëshme, asistentët e tyre të drejtpërdrejtë, punonjësit dhe vullnetarët në Shoqatën Nacionale.
- Forcimi i kapaciteteve të Shoqatës Nacionale për të ofruar mbështetje psikosociale në rast të një reagimi ndaj katastrofave natyrore, konflikteve dhe sfidave shëndetësore.
- Janë prezantuar metoda dhe teknika të reja për t'i dhënë mbështetje psikosociale kategorive të prekshme të personave në aktivitetet e programit të Shoqatës Nacionale.



# **BUXHETI I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020**

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut në buxhetin e tij qartë paraqet të ardhurat dhe shpenzimet vjetore, të cilat lejojnë konstruktimin e mënyrës së financimit të Organizatës dhe mundësinë e zbatimit të një aktiviteti, strategje dhe plani të caktuar.

Buxheti i përgjithshëm për vitin 2020 është rritur për 78,54 % në krahasim me Buxhetin e viti të kaluar. Rritja i referohet rritjes së të ardhurave si rezultat i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Kryqit të Kuq në pjesën e mbledhjes (marrjes) së kompensimit për KK me rastin e regjistrimit të automjeteve motorike, kështu që pagesa e kompensimit të regjistrimit të automjeteve bëhet në Zyrën Qendrore të KKRMV, e cila më pas shpërndahet në OKKK dhe KKQSH.

Nga të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat e planifikuara vetjake marrin pjesë me 31,49 % dhe në shumën nominale janë rritur në krahasim me vitin e kaluar, dhe të ardhurat nga organet dhe donatorët marrin pjesë me 68,51 % dhe shënojnë rritje në shumën nominale në krahasim me vitin e kaluar kur ato merrnin pjesë me 66,88%.

Në pjesën e shpenzimeve, shpenzimet kapitale marrin pjesë me 1,25%, shpenzimet aktuale përbëjnë 97,77% dhe shpenzimet e donacioneve dhe ndihmave përbëjnë 0,98% të shpenzimeve totale. Këtë vit politika e Organizatës është përqendruar në zhvillimin e organizatave komunale të Kryqit të Kuq përmes fondeve të reja të zhvillimit, dukshmërisë dhe reagimit urgjent ndaj katastrofave të dedikuara ekskluzivisht përmes mbështetje, punë të vazhdueshme dhe zhvillim të OKKK/KKQSH, në përpunim automatik të dhënavëve, rrjedhje të shpejtë të informacionit dhe treguesve financiarë, bazë të saktë dhe gjithëpërfshirëse të dhënavëve dhe rritje të kapaciteteve të Shoqatës Nacionale në tërësi.

e përgjithshme në Buxhetin e viti 2020, 21,66% i referohen shpenzimeve për Zyrën e KKRMV, ndërsa 78,34% të Buxhetit të përgjithshëm janë dedikuar për organizatat komunale të KK dhe KK të Qytetit të Shkupit. Gjithashtu e rëndësishme është të përmendet se nga shpenzimet totale të Zyrës Qendrore, 58,06% janë transferime direkt në OKKK për realizimin e aktiviteteve programore dhe në shumën nominale janë rritur në mënyrë drastike në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i transferimit të mjeteve financiare nga kompensiimi me rastin e regjistrimit të automjeteve.

Si shpenzim i Zyrës Qendrore të KKRMV janë përfshirë shpenzimet e pagës së punonjësve, shpenzimet materiale dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme. Në pjesën e shpenzimeve dedikuar OKKK/KKQSH janë përfshirë shpenzimet e projekteve të siguruara nga donatorët ose të programave të siguruara nga institucionet.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut duke ndjekur trendët modernë përmes modernizimin dhe përsosjen e punës materiale-financiare, lejon transparencë dhe llogaridhënie në punë, përpunim automatik të dhënavëve, rrjedhje të shpejtë të informacionit dhe treguesve financiarë, bazë të saktë dhe gjithëpërfshirëse të dhënavëve dhe rritje të kapaciteteve të Shoqatës Nacionale në tërësi.

Buxheti i KKRMV-së është i realët, gjithëpërfshirës, i strukturuar, preciz dhe i balancuar, dhe mjetet financiare të planifikuara në Buxhetin e viti 2020, KKRMV do t'i përdorë me qëllim, në mënyrë racionale dhe ekonomike, me transparencë dhe llogaridhënie të plotë.

# BUXHETI I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020

	%	2020	2019	2018
<b>TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>100.00</b>	<b>107,220,440.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,353.00</b>
Burimet e veta	31.49	33,763,800.00	19,887,628.00	16,484,800.00
Nga organet dhe donatorët	68.51	73,456,640.00	40,165,080.00	62,101,553.00
<b>SHPENZIMET E PËRGJITHSHME</b>	<b>100.00</b>	<b>107,220,440.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,353.00</b>
Shpenzimet aktuale	97.77	104,832,240.00	53,246,008.00	56,374,113.00
Shpenzimet kapitale	1.25	1,336,400.00	1,606,700.00	1,212,240.00
Ndihmat dhe donacionet	0.98	1,051,800.00	5,200,000.00	21,000,000.00
<b>DALLIMI</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

## ■ TË ARDHURAT ■ ■ ■

PËRSHKIRMI	Burimet e veta të ardhurave	Të ardhurat nga organet/donatorët	Buxheti 2020	Buxheti 2019	Buxheti 2018
------------	--------------------------------	--------------------------------------	--------------	--------------	--------------

### TRANSFERIMET DHE DONACIONET

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - aktivitetet e programit	9,075,000.00		9,075,000.00	6,000,000.00	6,000,000.00
Dhurimi i gjakut (Ministria e Shëndetësisë)		8,500,000.00	8,500,000.00	6,600,000.00	6,458,500.00
Programet sociale-humanitare	1,200,000.00	1,429,472.00	2,629,472.00	3,150,000.00	4,950,000.00
Organizimi dhe zhvillimi			0.00	11,960,000.00	31,072,000.00
Fondi i Zhvillimit dhe Projekteve	1,728,000.00		1,728,000.00		
5% përfurnizim dhe përmirësim të softuerit dhe pajisjeve	297,000.00		297,000.00		
Ndihma e parë	3,350,000.00		3,350,000.00	3,250,000.00	2,500,000.00
Programet parandaluese-shëndetësore		3,366,428.00	3,366,428.00	3,393,760.00	5,277,688.00
Zhvillimi, bashkëpunimi dhe puna me të rinjtë	210,000.00	400,000.00	610,000.00	866,000.00	336,000.00
Gatishmëria dhe reagimi në katastrofa		1,696,640.00	1,696,640.00	863,320.00	2,099,564.00
Fondi i Reagimit Urgjent në Katastrofa	1,728,000.00		1,728,000.00		
10% për aktivitetet programore për katastrofat	594,000.00		594,000.00		
Diseminimi dhe DNH-ja			0.00	197,600.00	756,120.00
KK në aksion - PVH		300,000.00	300,000.00	300,000.00	300,000.00
Marrëdhëniet me publikun dhe standartet e brendimit			0.00	0.00	448,000.00
Fondi i Dukshmërisë	1,404,000.00		1,404,000.00		
Shërbimi i Kërkimit		1,905,500.00	1,905,500.00	920,400.00	939,680.00
Puna e projekti dhe mobilizimi i fondeve			0.00	0.00	0.00
Burimet njerëzore, monitorimi dhe evalvimi		507,600.00	507,600.00	0.00	0.00
Krijimi i politikave dhe menaxhimi i vullnetarëve dhe anëtarëve		400,000.00	400,000.00		

### TË ARDHURAT JO TATIMORE

Nga OKKK (në bazë të kotizimit)	1,770,000.00		1,770,000.00	1,180,000.00	1,180,000.00
Donacionet nga personat fizikë	140,000.00		140,000.00	350,000.00	300,000.00
Donacionet nga personat juridikë	600,000.00		600,000.00	500,000.00	500,000.00
Markat me pagesë shtesë (nga Ligji i KK)	400,000.00		400,000.00	300,000.00	300,000.00
Nga dhënia me qira e hapësirës afariste	1,918,800.00		1,918,800.00	1,918,800.00	1,918,800.00
Nga regjistrimi i automjeteve 85% për punën e projektit	5,049,000.00	54,951,000.00	60,000,000.00	14,202,828.00	11,180,000.00
Nga kurset për shpëtimtarët në ujë	100,000.00		100,000.00	100,000.00	70,000.00
Mjete të transferuara nga viti i kaluar	4,200,000.00		4,200,000.00	4,000,000.00	2,000,000.00

<b>TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>33,763,800.00</b>	<b>73,456,640.00</b>	<b>107,220,440.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,352.00</b>
-----------------------------------	----------------------	----------------------	-----------------------	----------------------	----------------------

# SHPENZIMET

PËRSHKIMI	Nga burimet e veta	Nga organet dhe donatorët	Buxheti 2020	Buxheti 2019	Buxheti 2018
<b>SHPRENZIMET AKTUALE</b>					
<b>PAGAT BAZË DHE KOMPENSIMET</b>					
Paga bruto e punonjësve	13,464,512.00	1,007,488.00	14,472,000.00	12,072,964.00	10,294,416.00
Kompensimi për pushimin vjetor	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Kompensime të tjera	40,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00
<b>KONTRIBUTET NGA PAGAT DHE TATIMI PERSONAL</b>					
Tatimi personal nga kompensimet (mëditjet, çmimet jubilare)	30,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00
<b>SHPRENZIMET E PËRGJITHSHME PËR PAGAT</b>	<b>13,534,512.00</b>	<b>1,007,488.00</b>	<b>14,542,000.00</b>	<b>12,142,964.00</b>	<b>10,364,416.00</b>
<b>SHPRENZIMET RRUGORE DHE DITORE</b>					
Udhëtimet jashtë vendit	250,000.00		250,000.00	100,000.00	70,000.00
<b>SHËRBIMET KOMUNALE</b>					
Energjia elektrike	660,000.00		660,000.00	780,000.00	720,000.00
Ujësjellësi dhe kanalizimi	60,000.00		60,000.00	60,000.00	50,000.00
Mbeturinat	90,000.00		90,000.00	90,000.00	90,000.00
<b>NGROHJA</b>					
Ngrohja qendore	480,000.00		480,000.00	480,000.00	480,000.00
<b>KOMUNIKIMI DHE TRANSPORTI</b>					
Posta	30,000.00		30,000.00	30,000.00	50,000.00
Telefoni dhe telefaksi	720,000.00		720,000.00	751,200.00	1,393,320.00
Mëditjet brenda dhe jashtë vendit	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
Karburantet	360,000.00		360,000.00	420,000.00	590,000.00
Shpenzimet për regjistrimin e automjeteve	435,000.00		435,000.00	435,000.00	360,000.00
Shpenzime të tjera të transportit (pagesat rrugore, larja e veturave, nojtitja e gomave)	84,000.00		84,000.00	50,000.00	50,000.00
<b>MATERIALET</b>					
Material i zyrës	220,000.00		220,000.00	120,000.00	106,750.00
Parapagimi për revista dhe literaturë profesionale	46,000.00		46,000.00	41,000.00	41,000.00
Shirita, kasetë dhe të tjera për AOP	100,000.00		100,000.00	100,000.00	50,000.00
Kopjimi, shtypja dhe botimi i materialeve	1,170,000.00	1,225,000.00	2,395,000.00	1,676,100.00	2,917,685.00
• Organizimi dhe zhvillimi			0.00	0.00	660,320.00
• Marrëdhëniet me publikun dhe standartet e brendimit	150,000.00		150,000.00	99,000.00	380,800.00
• Diseminimi dhe DNH-ja			0.00	0.00	0.00
• Programet parandaluese-shëndetësore			0.00	0.00	483,000.00
• Ndihma e parë	280,000.00		280,000.00	280,000.00	280,000.00
• Dhurimi i gjakut		1,025,000.00	1,025,000.00	767,100.00	758,500.00
• Programet sociale-humanitare	100,000.00		100,000.00	200,000.00	300,000.00
• Shërbimi i Kërkimit			0.00	260,000.00	0.00
• Puna e projekti dhe mobilizimi i fondeve	50,000.00		50,000.00	0.00	0.00
• Krijimi i politikave dhe manaxhimisë					
vullnetarëve dhe anëtarëve	590,000.00		590,000.00	0.00	0.00
• Gatishmëria dhe reagimi në katastrofa			0.00	20,000.00	55,065.00
• Zhvillimi, bashkëpunimi dhe puna me të rinjtë			0.00	50,000.00	0.00
• Burimet njerëzore, monitorimi dhe evalvimi					
Pije, produkte ushqimore, mjete të higjenës	173,000.00	173,000.00	200,000.00	273,428.00	
Materialet e mbrojtjes kundër zjarrit	20,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00
Materialet me qëllim special					
(materialet mjekësore, materialet elektrike)	160,000.00	551,228.00	711,228.00	602,000.00	310,000.00
Materiale të tjera	450,000.00		450,000.00	300,000.00	945,000.00
<b>MIRËMBAJTJA AKTUALE</b>					
Rregullimi dhe mirëmbajtja e veturave	250,000.00		250,000.00	250,000.00	200,000.00
Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
Shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërësës	100,000.00		100,000.00	200,000.00	350,000.00
Mirëmbajtja e softuerit dhe harduerit	516,000.00		516,000.00	691,500.00	312,000.00
<b>SHËRBIMET KONTRAKTUESE</b>					
Sherbimet e avokatit	120,000.00		120,000.00	120,000.00	159,780.00
Seminaret dhe takimet	6,578,400.00	2,788,250.00	9,366,650.00	7,286,670.00	11,393,210.00
• Organizimi dhe zhvillimi	20,000.00		20,000.00	1,840,000.00	1,180,000.00
• Marrëdhëniet me publikun dhe standartet e brendimit	30,000.00		30,000.00	65,000.00	80,000.00

• Diseminimi dhe DNH-ja		0.00	350,000.00	70,000.00
• KKA - PVH	150,000.00	150,000.00	150,000.00	450,000.00
• Programet parandaluese-shëndetësore	50,000.00	50,000.00	50,000.00	723,750.00
• Ndihma e parë	410,000.00	410,000.00	410,000.00	1,866,000.00
• Dhurimi i gjakut		375,000.00	375,000.00	452,900.00
• Programet sociale-humanitare	3,125,000.00	309,000.00	3,434,000.00	950,000.00
• Shërbimi i Kërkimit	10,000.00	731,250.00	741,250.00	3,505,000.00
• Puna e projekti dhe mobilizimi i foneve			0.00	10,000.00
• Zhvillimi, bashkëpunimi dhe puna me të rinjtë			0.00	10,000.00
• Gatishmëria dhe reagimi në katastrofa	635,400.00	465,400.00	1,100,800.00	980,000.00
• Krijimi i politikave dhe manaxhim i vullnetarëve				35,000.00
• dhe anëtarëve	100,000.00	400,000.00	500,000.00	278,370.00
• Krejtësim festimi i 70 vjetorit të Kryqit të Kuq të RM			0.00	0.00
• Mbledhjet dhe puna e Këshillit Udhëheqës	100,000.00		100,000.00	400,000.00
• Kuvendi i KKRMV-së	100,000.00		100,000.00	100,000.00
• Takimi me sekretarët / kryetarët	100,000.00		100,000.00	100,000.00
• Gara shtetërore e ndihmës së parë	350,000.00		350,000.00	100,000.00
• Këshilli i të rinjve/Trupi koordinues/				400,000.00
Akademia e të rinjve/	147,000.00		147,000.00	66,000.00
Kampi i të rinjve/				66,000.00
Takimi koordinues evropian	150,000.00		150,000.00	336,000.00
Burimet njerëzore, monitorimi dhe evalvimi		507,600.00	507,600.00	336,000.00
Seminare dhe takime	1,101,000.00		1,101,000.00	
Provizioni i Bankës	80,000.00		80,000.00	80,000.00
Sigurimi i pronës dhe sigurimi i objekteve	250,000.00		250,000.00	25,000.00
Shërbime të tjera financiare (kontrata për angazhime të kohë pas kohshme dhe të përkohshme)	1,317,412.00	3,299,950.00	4,617,362.00	2,886,214.00
Shërbime të tjera të kontraktuara (dogana, punëtorë për paketimin e ndihmës hum.), aktvendime gjyqësore, qiraja	50,000.00	3,299,950.00	4,617,362.00	50,000.00
Revizioni i jashtëm	100,000.00		100,000.00	100,000.00
Pagesa e anëtarësimit në organiza ndërkombëtare	206,000.00		206,000.00	150,000.00

#### **SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

Sigurimi i foneve	100,000.00	100,000.00	100,000.00	200,000.00
Shpenzimet për bashkëpunimin ndërkombëtar	300,000.00	50,000.00	350,000.00	200,000.00

#### **TRANSFERIME PËR ORGANIZATA JO PROFITABILE**

Transferet për OKKK-të	150,000.00	62,101,000.00	62,251,000.00	22,483,360.00	19,648,000.00
Fondi i zhvillimit	2,613,000.00		2,613,000.00	0.00	0.00
Fondi i dukshmërisë	1,404,000.00		1,404,000.00		
<b>SHPRENZIMET E PËRGJITHSHME AKTUALE</b>	<b>33,377,324.00</b>	<b>71,454,916.00</b>	<b>104,832,240.00</b>	<b>53,246,008.00</b>	<b>56,374,113.00</b>

#### **SHPRENZIMET KAPITALE**

<b>BLERJA E MOBILEVE DHE PAJISJES SË ZYRËS</b>		<b>115,189,890.00</b>	<b>62,208,778.00</b>	<b>70,685,008.00</b>
		103,428,240.00	53,246,008.00	56,374,113.00

#### **BLERJA E AUTOMJETEVE**

Blerja e automjetit (kredi për një automjet)	600,000.00		600,000.00	600,000.00	0.00
--	------------	--	------------	------------	------

#### **MIRËMBAJTJA BAZIKE DHE SPECIALE**

Investimet kapitale në OKKK		0.00	356,700.00	0.00
Mbështetja e zhvillimit të OKKK		0.00	500,000.00	250,000.00
Rindërtimi dhe renovimi i objekteve të ndërtimit	50,000.00		50,000.00	150,000.00
<b>SHPRENZIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE</b>	<b>736,400.00</b>	<b>600,000.00</b>	<b>1,336,400.00</b>	<b>1,606,700.00</b>
				<b>1,212,240.00</b>

#### **NDIHMA, DONACIONE DHE PAGESA TË TJERA**

Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera të subjekteve në natyrë	1,051,800.00		1,051,800.00	5,200,000.00	21,000,000.00
Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera të subjekteve në para		0.00			
<b>GJITHSEJ DONACIONE, NDIHMA DHE PAGESA TË TJERA</b>	<b>1,051,800.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,051,800.00</b>	<b>5,200,000.00</b>	<b>21,000,000.00</b>

<b>SHPENZIME TË PËRGJITHSHME</b>	<b>35,165,524.00</b>	<b>72,054,916.00</b>	<b>107,220,440.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,353.00</b>
----------------------------------	----------------------	----------------------	-----------------------	----------------------	----------------------

Shpenzimet për Zyrën Qendrore të KKRM-së	23,220,124.00	21.66
Shpenzimet për OKKK-të	84,000,316.00	78.34

